I.6 Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm *për moshën dhe* performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.

Mendimtar kreativ:

II.1 Gjen veçoritë *e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.*
II.3 Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
II.7 Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
II.8 Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha *të tjera në kohëzgjatje prej 3*-5 minuta.

Nxënës i suksesshëm:

III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

Komunikues produktiv:

IV. 4 Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet... etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Individ i shëndoshë:

V.5 Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.2 Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme *në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.*

VI.4 Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).

VI.6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

2.1 Dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet moshatarëve në klasë dhe në shkollë sa u përket talenteve, interesave dhe prirjeve për aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

3.1 Identifikon veglat, pajisjet dhe makinat e thjeshta të ekonomisë familjare.

3.2 Identifikon veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në iniciativa personale apo të propozuara nga mbikëqyrësi ose mësimdhënësi.

4.1 Përdor kompjuterin personal për komunikim fillestar.

7.1 Identifikon aktivitetet dhe bartësit e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, institucion parashkollor/shkollë dhe komunitet.

<u>TEMA MËSIMORE</u>: Planifikimi

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

Komunikues efektiv:

I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Mendimtar kreativ:

II.7 Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.

II.8 Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta.

Nxënës i suksesshëm:

III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.

III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
III.7 Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

Kontribuues produktiv:

IV.1 Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, me vizatim, me shenja apo me simbole, me dy-tri aktivitete ditore të veta, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre.
IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet... etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Individ i shëndoshë:

V.1 Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit të vet në të cilin jeton dhe vepron.
V.4 Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.3 Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
VI.5 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
VI.6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

1.1 Përshkruan ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet aktiviteteve që bëhen në shtëpi, në shkollë dhe në klasë.
1.2 Zbaton veprimtari praktike të thjeshta në familje, në shtëpi dhe në klasë, bazuar në detyrat e caktuara qartë nga mësuesi/ja dhe nga prindërit.
5.1 Përmes veprimeve praktike në ekonominë familjare kupton dhe përjeton faktorët që duhen marrë në konsideratë.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Profesionet **Planifikimi**	- Luan lojë me role për profesionin që ai e dëshiron. - Planifikon kohën e mësimit, lojës dhe ndihmës në familje. - Planifikon festa të ndryshme. - Planifikon blerje për festë shkollore. - Planifikon festa të ndryshme. - Arsyeton rëndësinë e planifikimit të ardhurave dhe shpenzimeve familjare.	**5.6** Projekt: Profesioni që më pëlqen më shumë... **6.1** Dita ime **6.2** Përgatitemi për festat **6.3** Kur bashkëpunojmë, festojmë edhe më bukur **6.4-5** Veprimtari: Përgatitim postera dhe zbukurime për festat **6.6** Test	7 orë	- DRTA - Stuhi mendimesh - Turi i galerisë - Vizualizimi - Ditari dypjesësh - Gushëkuqi rrethor - Pyetje binare - Rrjeti i diskutimit - Mësimdhënia e ndërsjellë - Mësimdhënia dhe të nxënët me fëmijën në qendër dhe gjithëpërfshirja. - Të nxënët përmes lojës. - Mësimdhënia dhe të nxënët e integruar. - Mësimdhënia dhe të nxënët bazuar në arritjen e kompetencave. - Të mësuarit përmes projekteve. - Të mësuarit përmes hulumtimit.	Buletini i pjesëmarrjes Lista e kontrollit Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë Semafori Dy yje një dëshirë Vetëvlerësim Test Vlerësim përmes organizuesit grafik	Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë **Çështjet ndërkurrikulare** - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	Tekstet shkollore, Librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, Librat e punës, Broshura, Atlase, Enciklopedi Softuerë arsimorë, Projekte **Interneti:** *https://www.pinterest.com/pin/AfiphR8_qLr4XLpvOBC4GovSR-hVukmli626n4E7APMBNI8-lXfW-tg/*

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës:** I	**Klasa:** I
Tema: Kujdesi ndaj ambientit dhe ruajtja e shëndetit			
Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan disa rregulla të higjienës dhe i zbaton në jetën e përditshme.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3, 7; **II.** 5, 7; **III.** 7; **IV.** 3, 4, 5, 6; **V.** 1, 4, 7; **IV.** 6, 7 **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: **1.** 1, 2; **6.** 1; **7.** 1; **9.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
Njësia mësimore: Unë di	**Fjalët kyçe:** lëndë, shkathtësi, mjedisi, shëndeti, trafiku, profesionet, planifikimi etj.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - emërton saktë veprimin e shokut duke u bazuar në lëvizjet trupore; - analizon me kujdes lidhshmërinë e ilustrimit me konceptin e dhënë; - argumenton përmes vizatimit veprimin që ai vlerëson më shumë. ***Kriteret e suksesit:*** Gjej veprimin sipas kritereve të caktuara në lojë. Identifiko lidhshmërinë e ilustrimit me konceptin e dhënë. Arsyeto vlerësimin që ke bërë me së paku dy fjali.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: burime nga interneti, libri i nxënësit, karta me ilustrime.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë dhe komunikim, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Edukata fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Luhet loja: "Gjej se çfarë po imitoj".

Mësuesi/ja i ofron secilit grup nga një ilustrim me situata të ndryshme nga jeta e përditshme, u kërkon nxënësve që t'i analizojnë dhe t'i paraqesin ato përmes lëvizjeve trupore para klasës. Grupi që e gjen i pari imitimin, merr fjalën. Hapet diskutimi:

- Çfarë veprimesh janë këto?
- Çfarë ju kujtojnë këto veprime?
- Sa i zbatoni në jetën e përditshme veprimet e tilla? Pse?

Pas një diskutimi të orientuar nga pyetjet e shtruara nga mësuesi/ja arrijmë në konceptin *Shkathtësi për jetë* (Njohja e nxënësve me lëndën e re mësimore).

Hapi 2

Hapen librat. Mësuesi/ja bën njoftimin dhe sqarimin e tërthortë të përmbajtjes së lëndës duke e lidhur me ilustrimet në faqen e parë të librit, p.sh.:

- Pse duhet ta mbajmë trupin dhe ambientin pastër?
- Çfarë ndodh nëse nuk kujdesemi për higjienën personale?
- Cili është qëndrimi juaj ndaj fëmijëve që nuk kujdesen për higjienën e trupit dhe atë të mjedisit?
- Po ju si veproni për të mbajtur pastër higjienën personale dhe atë të mjedisit?

Në këtë mënyrë arrijmë të zbërthejmë secilën situatë dhe të sqarojmë përmbajtjen lëndore të lëndës së re mësimore.

Hapi 3 *Punë individuale*

Nxënësve u kërkohet që të vizatojnë në mënyrë individuale njërën prej situatave që ata e shohin si më të rëndësishme dhe t'i arsyetojnë mendimet e tyre përmes turit të galerisë (apo telit tharës) duke e argumentuar punën para klase.

Vlerësimi i nxënësve
- Buletini i pjesëmarrjes - Lista e kontrollit
Detyrë shtëpie

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Mjedisi			
Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon materialet ricikluese që e rrethojnë në shtëpi dhe shkollë.		**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës**: **I.** 3, 7; **II.** 7; **III.** 1, 2, 3 7; **IV.** 3, 4, 5, 6; **V.** 5, 7; **IV.** 2, 4, 6	

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
1.1- **Njësia mësimore*:*** Ne kujdesemi për gjithçka që na rrethon	**Fjalët kyçe**: mjedis, riciklim, materiale, druri, plastika, duralumini, qelqi, lëkura etj.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - ilustron rrugën e imagjinuar duke e përshtatur me mjedisin që e rrethon; - dallon llojet e materialeve në mjedisin që e rrethon; - kombinon saktë objektin me materialin sipas shembullit të dhënë. ***Kriteret e suksesit:*** Krijo mjedisin ku jeton sipas imagjinatës. Gjej llojet e materialeve në objektet që të rrethojnë. Plotëso pa gabime kërkesën e detyrës së dhënë.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, fleta A4, gazeta, karta të ilustruara.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare: Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Aktivitet: ***Rruga imagjinare***

Nën tingujt e një muzike të lehtë, të gjithë nxënësve u ofrohet nga një fletë A4 dhe një ngjyrë e çfarëdoshme. Nxënësit me sy të mbyllur prekin fletën për t'u njohur me hapësirën në të cilën kanë për të vizatuar. Atyre u kërkohet të imagjinojnë një rrugë dhe ta vizatojnë atë në fletë. Pasi hapin sytë e detajojnë punimin duke e plotësuar (me fotot nga gazetat, vizatime, karta me ilustrime) rrugën imagjinare me mjedisin ku jetojnë si shtëpinë e tyre, shkollën, parkun etj. Në këtë mënyrë, nxënësit familjarizohen me konceptin e mjedisit dhe e ilustrojnë punimin sipas dëshirës.

Hapi 2

Hapen librat, lexohet teksti i shkurtër në libër dhe komentohen ilustrimet. Ndërkohë mësuesi/ja shtron pyetjet:

- Ku banoni ju?
- Si duket shtëpia ku banoni?

- Me se është e ndërtuar shtëpia apo shkolla juaj?
- Si veproni kur dëmtohen objektet e shtëpisë apo të shkollës suaj? Pse?

Njëkohësisht sqaron përparësinë e përdorimit të shisheve të qelqit kundrejt atyre plastikeve. Mësuesi/ja i jep rëndësi të veçantë shenjës së riciklimit (materialet që riprodhohen), për t'i përgatitur nxënësit për temën që do të trajtohet në orën e ardhshme.

Mësuesi/ja paraqet objekte të ndryshme para klase (objekte (lodra) prej druri, prej plastike, lëkure, qelqi etj.)

Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe i analizojnë.

- Çfarë është?
- Me kë ngjason? Nga se ndryshon?
- Si është e ndërtuar?
- Me çfarë materiali është punuar?
- Cili prej këtyre materialeve që janë formuar lodrat është më i përshtatshëm për të luajtur me të? Pse?

Hapi 3

Në këtë mënyrë arrijmë te llojet e materialeve. Nxënësit orientohen të shkruajnë emrin e objektit dhe numrin e llojit të materialit në libër. **P.sh.**:

Hapi 4

Nxënësit i shkëmbejnë detyrat e tyre dhe reflektojnë për punën e njëri-tjetrit. "Kontrolluesi" (nxënësi kontrollues) identifikon dy elemente/ide pozitive (yje) në detyrën e shokut/shoqes dhe një aspekt tjetër të punës/detyrës ku ka nevojë për përmirësim apo zhvillim të mëtejshëm (dëshirë).

1. Druri 2.Plastike 3.Lëkurë 4.Tekstil 5.Duroalumin

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes Dy yje dhe një dëshirë
Detyrë shtëpie
Hulumto në internet, gazeta apo revista (me ndihmën e prindërve) për materialet e ricikluesshme dhe sill informacione në klasë.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Mjedisi			
Rezultati i të nxënit të temës: Klasifikon materialet ricikluese dhe ato joricikluese.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3, 7; **II.** 7; **III.** 1, 2, 3, 7; **IV.** 3, 4, 5, 6; **V.** 5, 7; **IV.** 2, 4, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: **1.** 2; **9.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
1.2 Njësia mësimore: Mbrojtja e mjedisit	**Fjalët kyçe**: riciklim, druri, suvaja, plastika, ambalazhet nga kartoni, kënaçet, shenjën *PET*.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore: ***Nxënësi/ja:*** - tregon qartë informacionet që ka sjell në klasë për materialet e ricikluesshme; - kategorizon drejt materialet e ricikluesshme nga ato të paricikluesshme; - argumenton rëndësinë e përdorimit të materialeve të ricikluesshme përmes debatit në klasë. ***Kriteret e suksesit:*** Sqaro informacionin që ke sjell për materialet e ricikluesshme. Veço materialet e ricikluesshme nga ato të paricikluesshme. Shpjego rëndësinë e përdorimit të materialeve të tilla.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: lap-top, projektor, ilustrime të marra nga interneti, libri i nxënësit, sende të ndërtuara nga materiale të ndryshme, si shishe plastike, ambalazhe të ndryshme, tasa letre etj.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore**: Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet ndërkurrikulare: Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Nxënësit janë udhëzuar të hulumtojnë në internet (me ndihmën e prindërve) për materialet e ricikluesshme dhe të sjellin ide, foto, adresa interneti etj. Fillimisht hapet diskutimi dhe shqyrtohen informacionet që kanë sjell nxënësit në klasë. Më pas hapet diskutimi bazohet në ilustrimet (apo *link* p.sh. *https://www.simplykinder.com/free-recycling-sort/*) që ka sjellë mësuesi/ja.

- Çfarë shihni në ilustrim?
- Si ju duken, me çfarë materiali janë punuar ato?
- A mendoni që materiali me të cilin janë punuar është riciklues? Pse?
- Çfarë materiali tjetër mund të ripërdoret? (diskutim)



Hapi 2

Hapen librat, analizohet teksti i shoqëruar me ilustrime dhe nxënësit arrijnë në përfundim se shumë materiale si p.sh. druri, suvaja, plastika, ambalazhet nga kartoni, kënaçet, metale të ndryshme etj., janë të ricikluesshme. Ato kanë shenjen e riciklimit për t'i dalluar, sepse jo të gjitha materialet janë të ricikluesshme. Pra, materialet e paricikluesshme janë të gjitha shishet plastike që nuk e kanë shenjën *PET,* që do të thotë se nuk riciklohen p.sh., ambalazhet e kartonit të plastifikuara ose me veshje alumini, bateritë etj. (të gjitha këto objekte duhet të sillen në klasë apo të paraqiten në video-projektor, në mënyrë që nxënësit t'i shohin konkretisht).

Në rastin më sipër çfarë kemi bërë? (kemi ripërdorur)

Mësuesi/ja paraqet moton "Ripërdor, redukto, riciklo"

Ripërdor - tasin

Redukto - shpenzimin e ujit

Riciklo - materialet që duhet (diskutim i përbashkët)

Hapi 3

Nxënësit plotësojnë kërkesën e detyrës në libër në mënyrë individuale dhe e diskutojnë në çift për ta paraqitur para klasës.

- Si mendoni se ndikon përdorimi i materialeve të ricikluesshme në mbrojtjen e mjedisit?
- A janë të gjithë fëmijët e kujdesshëm në mbrojtjen e mjedisit?

Po, pse?	Jo, Pse?

Klasa do të ndahet në dy grupe dhe nxënësit do të përcaktojnë pozicionin e tyre. Bëhet një raportim para klasës për arsyet se pse kanë zgjedhur të jenë pro ose kundër çështjes. Gjatë kohës që dy grupet raportojnë arsyet e tyre, nxënësit mund të ndryshojnë pozicion dhe të shkojnë në grupin që paraqet arsyet më bindëse.

(Kjo njësi mësimore do të shoqërohet me një organizues grafik)

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes Lista e kontrollit gjatë debatit
Detyrë shtëpie
Udhëzojini nxënësit që duke përdorur materiale ricikluese (tasa letre, kartonë, plastelinë), të vizatojnë dhe të krijojnë personazhe që shprehin emocione të ndryshme.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Mjedisi			
Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan lagjen e tij/saj pa mbeturina	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës**: **I.** 3, 7; **II.** 7; **III.** 1, 2, 3, 7; **IV.** 3, 4, 5, 6; **V.** 5, 7; **IV.** 2, 4, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: **1**. 2; **9**. 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
1.3 Njësia mësimore: Unë kujdesem për mjedisin ku jetoj	**Fjalët kyçe:** riciklimi, mjedisi, pastërtia në shtëpi, lagje, shkollë, oborr, burimet natyrore, energji.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore: ***Nxënësi/ja:*** - përcakton saktë pozicionin e tij duke u bazuar në kërkesën e lojës; - interpreton veprimin e tij në situata të caktuara, bazuar në informacionin e marr; - argumenton qëndrimin e tij ndaj veprimeve të papërshtatshme. ***Kriteret e suksesit:*** Ndaj përgjegjësitë në pastrimin e klasës. Vizato veprimin tënd në situatat në shembujt e dhënë. Shpjego qëndrimin tënd ndaj personave që hedhin mbeturinat në vende të pacaktuara.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, organizuesi grafik, teli tharës.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare: Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1 Aktivitet në mjediset e shkollës.

Nxënësit ndahen në grupe. Mësuesi/ja përmend një artikull ushqimor. Një nga nxënësit e grupit duhet të vrapoj te shporta përkatëse që tregon se me cilin material është ambalazhuar ushqimi: letër apo karton, plastikë, qelq. Shembull: *Qumësht – nxënësi/ja duhet të shkoj te koshi përkatës.*

Grupi që ka gjetur më shumë artikuj, fiton.

Hapi 2

Hapen librat, paraqitet njësia e re dhe diskutohet situata e parë. Nxënësit plotësojnë situatën e parë në organizuesin grafik. Në të gjitha situatat veprohet në këtë mënyrë.

Për të ruajtur mjedisin duhet të kujdesen të gjithë. Si veproni ju për mirëmbajtjen e mjedisit?

Situata 1. Shtëpia (Shkruaj se si kontribuon ti në mirëmbajtjen e pastërtisë në shtëpi.)	**Situata 2.** Lagjja (Vizato çfarë do të doje të shtoje në lagjen tënde, në mënyrë që ajri të jetë më i pastër dhe të ketë aromë të mirë.)
Situata 3. Klasa (Si do të ndihmoje ti në pastërtinë e klasës?)	**Situata 4.** Oborri (Vizato apo shkruaj çfarë do të bëje në oborrin e shkollës që mjedisi përreth saj të ishte i pastër.)

Arrijmë në përfundim se:

- me anë të riciklimit zvogëlohet sasia e mbeturinave dhe ndotja e mjedisit;
- me anë të riciklimit kursejmë burimet natyrore dhe energjinë.

Hapi 3

Të gjitha punimet ekspozohen në murin e klasës (teli tharës), dhe nxënësit sqarojnë punimet e tyre.

Në fund, nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Si do të vepronit nëse shikoni që dikush nuk i hedh mbeturinat ne vendin e duhur në shtëpi, në lagje dhe në shkollë?
- Cili është qëndrimi juaj ndaj njerëzve të tillë?
- Çfarë mesazhi do t'i dërgoni atyre?

Nxënësit vizatojnë në çift, plotësojnë me foto dhe shkruajnë mesazhe për mbrojtjen e mjedisit

(Punimet që ata krijojnë, janë hapat e parë të përgatitjes së projektit "Të mbrojmë mjedisin", që do të finalizohet në 22 Prill që është dita e Tokës).

Vlerësimi i nxënësve
Vlerësohen nxënësit për përgjigjet e dhëna në organizuesin grafik. Sqarimi i punimeve gjatë turit të galerisë Buletini i pjesëmarrjes
Detyrë shtëpie
Vizato apo shkruaj me 2-3 fjali për një situatë ku ke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit (shtëpi, shkollë, lagje apo oborr). Sill nga shtëpia materiale që nuk përdoren, dhe që mendon se mund t'i riciklohen.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Mjedisi			
Rezultati i të nxënit të temës: Grumbullon materiale ricikluese duke krijuar forma të ndryshme me to.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës**: **I.** 3, 7; **II.** 7; **III.** 1, 2, 3, 7; **IV.** 2, 4, 5, 6; **V.** 5, 7; **IV.** 2, 4, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: **1.** 1, 2; **8.** 1; **9.** 1		
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
1.4-5. Njësia mësimore "Projekt": Si t'i riciklojmë materialet	**Fjalët kyçe**: riciklim, komunitet, përpunim, vizatim, krijim, material		
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - përshkruan qartë përfundimet e nxjerra në grup për ilustrimin; - përdorë me kujdes mjetet e punës; - krijon objekte të përdorshme me materiale të ricikluesshme. ***Kriteret e suksesit:*** Sqaro situatën në ilustrim me një apo dy fjali. Përdor me kujdes mjetet e nevojshme të punës. Krijo një objekt me materialet në dispozicion.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, Burime nga interneti, Materiale të ricikluesshme, Materiale jo të ricikluesshme.	**Lidhja me lëndët tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Matematikë.		
Çështjet ndërkurrikulare: Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Luhet loja "Gjej objektet".

Për realizimin e lojës nevojiten:

- materiale të ricikluesshme si plastik, letër, qelq, alumin etj.;
- Materiale të pa ricikluesshme si bateri, laps, kuti me veshje alumini etj.

1. Fshihni objekte nëpër klasë para se të hyjnë nxënësit.
2. Bëni një listë të objekteve që keni fshehur që t'ua jepni grupeve të nxënësve për t'i gjetur.
3. Ndani nxënësit në grupe dhe jepni listën e gjërave që duhet të gjejnë. Nxënësit kanë 5 min. kohë për t'i gjetur objektet.
4. Grupi që i gjen materialet brenda kohës së dhënë duhet t'i ndaj materialet në të ricikluesshme dhe të pa ricikluesshme.

Në klasë nis diskutimi:

- Çfarë janë ato?
- Pse mendoni se mund t'i përdorim?
- A janë materiale të ricikluesshme? Pse?
- Si mendon ti, për çfarë mund t'i përdorim ato?

Hapi 2

Hapen librat dhe nxënësit njihen me temën.

Secilit grup i caktohet si detyrë të hulumtojë një nga ilustrimet, duke u bazuar në kriteret që sqaron mësuesi/ja:

Vëzhgo - mendo - diskuto - zbulo - argumento

Nxënësit pasi të kenë analizuar ilustrimin, reflektojnë në grup. Secili prej anëtarëve të grupit jep mendimin e vet për hulumtimin e bërë.

Nxënësit arrijnë në përfundim se:

- Goma e makinës u shndërrua në kopsht me lule.
- Kavanozat e qelqit mund t'i bëjmë vazo me lule.
- Shishet mund t'i bëjmë si abazhur.
- Shishet plastike mund t'i riciklojmë si vazo me lule.
- Gotat dhe pjatat njëpërdorimshme t'i zbukurojmë dhe t'i vëmë në dhomë si dekor.

Hapi 3

Për t'i ndihmuar nxënësit paraqiten shembuj të ndryshëm në video-projektor "Përpunim i materialeve të ricikluesshme". *https://www.youtube.com/watch?v=jbOg9GyWNfc*

Nxënësit ndajnë përgjegjësit në grup për të punuar shembujt 5, 6, 7, 8 dhe 9 në librin e nxënësit. Atyre u ofrohen materialet dhe sipas udhëzimeve të mësuesit/es fillon puna praktike.

Hapi 4.

Punimet ekspozohen në raftet e klasë dhe nxënësit diskutojnë, i krahasojnë, shkëmbejnë përvojat për punën e bërë dhe u sqarojnë shokëve dhe shoqeve të klasës mënyrën e përdorimit të krijimeve të tyre.

Vlerësimi i nxënësve
Vlerësohen nxënësit për argumentet individuale gjatë analizës së ilustrimit. Lista e kontrollit gjatë punës praktike Vlerësim i ndërsjellët për produktin e fituar me punë praktike
Detyrë shtëpie
Krijo një objekt të thjeshtë me materialet që nuk përdorni në shtëpi dhe sjell në klasë.

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna</td><td>Lënda: Shkathtësi për jetë</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: I</td></tr>
<tr><td colspan="4">Tema: Mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultati i të nxënit të temës: Praktikon hedhjen e mbeturinave në bazë të emërtimeve në shportat e caktuara</td><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 7; II. 7; III. 1, 2, 3, 7; IV. 2, 4, 5, 6; V. 5, 7; IV. 2, 4, 6</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 2; 9. 1</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="2">1.6 Njësia mësimore: Kontrollo përparimin tënd</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: riciklim, material riciklues, ripërdor, redukto.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:
- klasifikon tiketat e materialeve të ricikluesshme në shportat përkatëse;
- plotëson pa gabime kërkesat e detyrave të dhëna;
- korrigjon detyrën e shokut në krah dhe e paraqet rezultatin para klase.

Kriteret e suksesit:
Vendos tiketat në kutinë e duhur.
Dallo përgjigjen e saktë në detyrë.
Vlerëso detyrën e shokut/shoqes.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, tiketa të ilustruara, kuti kartoni, organizuesi grafik.</td><td colspan="2">Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Edukata fizike, sporti dhe shëndeti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Çështjet ndërkurrikulare: Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike</td></tr>
</table>

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Luhet loja "Bigo".

Mësuesi/ja përgatit ilustrime të printuara të materialeve të ricikluesshme dhe jo të ricikluesshme. Vendosen koshat riciklues prej kartoni (mund të jenë kuti këpucësh). Nxënësit duhet të vendosin materialin përkatës në kutinë e duhur (letër, plastikë, qelq). Materialet joricikluese mbesin jashtë kutive. Grupi që mbaron i pari, thërret "Bingo".

Hapi 2

Hapen librat, mësuesi/ja sqaron kërkesat e detyrave dhe nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për të kontrolluar përparimin e njohurive. Detyrën e dytë e diskutojnë në çift me shokun e bankës, pastaj e shpjegojnë para klasës.

Hapi 3

Nxënësit shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe korrigjojnë punën e shokut në krahë me laps të kuq. Mësuesi/ja qëndron gjithnjë në vëzhgim të punës së nxënësve dhe ndërhyn në situatat e nevojshme.

Më pas nxënësit diskutojnë për punën e bërë.

Hapi 4

Për t'u bindur se nxënësit kanë arritur rezultatet e pritura, mësuesi/ja përdor Organizuesin grafik me kërkesat si më poshtë.

Secili nxënës, plotëson në mënyrë individuale kërkesat e detyrave të dhëna në Organizuesin grafik.

Shkruaj apo vizato:

- tri artikuj që mund t'i riciklosh;
- dy artikuj që mund t'i ripërdorësh;
- një mënyrë që mund të reduktojë ndotjen.

(Në përfundim të kësaj teme, nxënësit do të paraqesin projektin e tyre "Të mbrojmë mjedisin". Ata do të prezantojnë punimet që kanë realizuar gjatë kësaj teme. Një tjetër variant për realizimin e këtij projekti është organizimi i një fushate nga ana fëmijëve qytet/fshat për mbrojtjen e mjedisit. Paraqitja e projektit bëhet në ditën e Tokës me 22 Prill. Në këtë ditë sugjerohet një vizitë në ndërmarrjen e mirëmbajtjes së qytetit.)

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes Vlerësim me gojë *në plotësimin e detyrave*
Vlerësimi i nxënësve
Sjell në klasë informacione nga interneti (me ndihmën e prindërve) për mbrojtjen e mjedisit.

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna</td><td>Lënda: Shkathtësi për jetë</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: I</td></tr>
<tr><td colspan="4">Tema: Kujdesi ndaj ambientit dhe ruajtja e shëndetit</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon mjetet dhe mënyrat e higjienës personale, si dhe shkaktarët e mundshëm që ndikojnë negativisht në shëndetin tonë.</td><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; III. 2, 3, 7; IV. 1, 4, 5, 6; V. 1, 7; VI. 2</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 6. 1</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="2">2.1 Njësia mësimore: Higjiena ime</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: Higjiena personale, mikrobe, pastërtia, mjetet për mirëmbajtjen e higjienës personale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:
- tregon interesim gjatë ligjëratës për higjienën personale nga mjeku familjar;
- shpjegon saktë disa rregulla të mirëmbajtjes së higjienës personale;
- krijon listën e mjeteve të higjienës personale që përdorë.

Kriteret e suksesit:
Pyet mjekun familjar për gjërat që nuk kupton.
Thuaj saktë rregullat e nevojshme për mirëmbajtjen e higjienës personale.
Identifiko mjetet e higjienës personale sipas kritereve në ushtrim.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime njerëzore, mjeku familjar (shfrytëzo informacione në internet <u>https://www.youtube.com/watch?v=jQ2e0KH5WrI</u>), libri i nxënësit, Organizues grafik, mjetet e higjienës personale.</td><td colspan="2">Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë</td></tr>
</table>

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Ftohet mjeku i familjes në klasë për të mbajtur një ligjëratë të shkurtër për higjienën personale.

Në mungesë të mjekut shfrytëzohet *link*-u *https://www.youtube.com/watch?v=jQ2e0KH5WrI* . (Paraprakisht, sugjerohet që mësuesi/ja të njihet me përmbajtjen e *link*-ut.)

Hapi 2

Hapen librat dhe nxënësit shohin ilustrimet në tekst. Ata bëjnë lidhjen e ligjëratës së mjekut me ilustrimet dhe me mjetet e higjienës personale që ndodhen në klasë.

Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe imitojnë veprimet në ilustrim. Ata diskutojnë për situatën e caktuar nga mësuesi/ja p.sh., *grupi **I** situatën 1* e kështu me radhë. Nxënësit sqarojnë veprimet duke u bazuar në pyetjet e mëposhtme.

- Çfarë ju kujtojnë veprimet (ilustrimet) në tekst?
- Kur i bëni këto veprime?
- Pse duhet kryer këto veprime çdo ditë?
- Çfarë kupton me fjalët "higjienë personale"?
- Çfarë ndodhë nëse nuk kujdesesh për higjienën personale?
- Çfarë masash duhet të marrim që t'i largojmë mikrobet nga trupi ynë?
- Si i kryeni ju këto veprime, me ndihmën e prindit apo vet?
- Çfarë ju tregoi xhaxhi mjeku?
- Sa të kujdesshëm jeni ju për higjienën personale?
- Cila është arsyeja?
- Pyet shokun/shoqen e bankës, a vepron edhe ai kështu si ti?

Në këtë mënyrë, nxënësit arrijnë të kuptojnë rëndësinë dhe rregullat e mirëmbajtjes së higjienës personale.

Hapi 3

Nxënësit plotësojnë detyrat sipas kritereve të dhëna (nën vëzhgimin e mësuesit/es), duke renditur dhe sqaruar veprimet e vajzës në ilustrim. Ata plotësojnë listën me objektet që përdorin, pastaj vijojnë me diskutimin e përbashkët sipas udhëzimeve në libër.

Hapi 4

Në varësi të kohës në dispozicion plotësohet Organizuesi grafik, në mënyrë individuale.

Puna e nxënësve shoqërohet me Vlerësim të vazhduar nga mësuesi/ja.

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes Renditja e mjeteve dhe rregullave të higjienës Plotësimi i saktë i Organizuesit grafik
Detyrë shtëpie
Vizato mjetet e higjienës personale dhe pastaj priji me gërshërë.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Kujdesi ndaj ambientit dhe ruajtja e shëndetit			
Rezultati i të nxënit të temë: Kujdeset për ambientin e tij/saj në të cilin ka punuar pasi të ketë përfunduar detyrën/aktivitetin e caktuar, nxënësi/ja pastron.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës**: **I.** 3; **III.** 2, 3, 7; **IV.** 1, 4, 5, 6; **V.** 1, 7; **VI.** 2 **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: **1.** 1, 2; **6.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
2.2 Njësia mësimore: Kujdesi për higjienën në shtëpi dhe në shkollë	**Fjalët kyçe:** higjienë, rregull
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore: **Nxënësi/ja:** - dallon parregullsitë duke i krahasuar dy ilustrimet; - sqaron arsyen e mirëmbajtjes së higjienës në shtëpi/shkollë; - interpreton rezultatin e hulumtimit rreth pastërtisë në klasë/oborr. Kriteret e suksesit: Krahaso dy ilustrimet dhe sill përfundim. Trego rëndësinë e mirëmbajtjes së higjienës në shtëpi/shkollë. Ndaj përgjegjësitë për mirëmbajtjen e higjienës në klasë/oborr.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, fletë **A4.**	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Hapet diskutimi në klasë duke bërë krahasimin e dy ilustrimeve.



Përmes Diagramit të Venit, nxënësit gjejnë të përbashkëtat dhe të veçantat e dy ilustrimeve. Duke i krahasuar, ata japin komentet e tyre p.sh. Të përbashkët – janë dhoma të shtëpisë, kanë gjëra të nevojshme për

njeriun etj. Vëmendje të veçantë mësuesi/ja i kushton të veçantave, ku nxënësit duhet të dallojnë parregullsitë në dhomën e gjumit.

Hapi 2

Mësuesi/ja lexon tekstin që shoqëron ilustrimet dhe shtron pyetjen:

Si të pëlqen vendi ku mëson **A** apo **B**? (nxënësit zgjedhin figurën në libër, duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre). Duke e lidhur me figurën, mësuesi/ja bën lidhjen e higjienës në shtëpi me atë në klasë. Më pas lexon paragrafët dhe nëpërmjet diskutimit të përbashkët, nxënësit arrijnë ta kuptojnë që higjiena në ambientin shkollorë është po aq e rëndësishme sa higjiena në shtëpi. Ajo ruhet duke hedhur mbeturinat në vendet e caktuara, duke bërë shtimin dhe ruajtjen e gjelbërimit.

Hapi 3

Nxënësit nxiten për përgjegjësinë e mirëmbajtjes së higjienës duke e treguar videon e mëposhtme. (*https://www.youtube.com/watch?v=dRV7YdygqAg*)

Hapi 4

Nxënësit ndahen në grupe dhe udhëzohen të hulumtojnë në klasë ose në oborrin e shkollës dhe të shohin nëse është i pastër dhe të diskutojnë se si mund ta mbajnë pastër.

Secili prej anëtarëve të grupit jep informatat që ka nxjerr, për planifikuar ndarjen e përgjegjësive për ruajtjen e higjienës së ambientit të shkollës. Nxënësit nxiten që të planifikojnë edhe mbjelljen e bimëve në oborrin e shkollës gjatë aktivitetit për ditën e Tokës.

Vlerësimi i nxënësve
Përfundimi i nxjerr nga krahasimi i ilustrimeve Buletini i pjesëmarrjes Hulumtimi i ambientit dhe ndarja e përgjegjësive
Detyrë shtëpie
Shkruaj një mesazh për higjienën në shkollë.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Kujdesi ndaj ambientit dhe ruajtja e shëndetit			
Rezultati i të nxënit të temës: Përdor disa mjete higjienike të thjeshta dhe rregullat për mbajtjen e pastërtisë	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3; **III.** 2, 3, 7; **IV.** 1, 4, 5, 6; **V.** 1, 7; **VI.** 2 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.** 1, 2; **6.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
2.3 Njësia mësimore: Unë ndihmoj në pastrimin e shtëpisë ose të shkollës	**Fjalët kyçe**: Mikrobe, higjiena, mirëmbajtje, pastërtia në shtëpi, pastërtia në shkollë.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - thotë çfarë di për mirëmbajtjen e higjienës në shtëpi dhe në shkollë; - eksperimenton bartjen e mikrobeve përmes lojës së thjeshtë me xixa; - argumenton rezultatet përmes kontributit personal. ***Kriteret e suksesit:*** Tregon për mirëmbajtjen e higjienës në shtëpi dhe në shkollë. Argumenton bartjen e xixave (mikrobeve) përmes lojës. Deklaron kontributin e tij për mirëmbajtjen e higjienës në shtëpi dhe në shkollë.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, kënga për mikrobin (literaturë), kuti këpucësh, xixa vezulluese, fleta A3.	**Lidhja me lëndët tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Shoqëria dhe mjedisi
Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Aktiviteti fillon me këngën e mikrobit.

Këngë për mikrobin

Një mikrob shumë i vockël
Dëshiron të bëhet shumë i madh
Dëshiron të zotërojë Botën
Dhe një ditë filloi të:
Njam e njam e filloi të hajë
(Marrë nga libri "Rruga e hulumtimeve")

Pasi të dëgjojnë këngën, përmes pyetjeve bëhet një përsëritje rreth asaj çka është mësuar orë më parë për higjienën.

Hapi 2 ***Eksperiment***

Nxënësit bëjnë një rreth dhe kalojnë dorë pas dore një kuti të vogël (kutia është e lyer me xixa qëllimisht nga mësuesi/ja). Nxënësit duhet të gjejnë se çfarë ka brenda kutisë. Pasi përfundon loja, mësuesi/ja i stimulon nxënësit të diskutojnë rreth eksperimentit duke u shtruar pyetje:

- Çfarë keni në trup (duar)?
- Si kanë arritur xixat në duart tuaja? (duke kaluar kutinë dorë më dorë)
- Me çfarë mund ta krahasoni bartjen e xixave në duart tuaja? (me mikrobet).

Në këtë mënyrë nxënësit arrijnë në përfundim se mikrobet i ngjan xixave dhe ato barten përmes kontaktit dhe ajrit.

- Çfarë mund të bëjmë për të evituar ngjitjen e mikrobeve?
- Si të veprojmë që në ambientin ku jetojmë të ketë sa më pak mikrobe?
- (mendimet e nxënësve shënohen në fleta A3 dhe vendosen në mur)

Hapi 3

Hapen librat, mësuesi/ja lexon tekstin me ndalesa sipas paragrafëve dhe integron përvojat e nxënësve përmes pyetjeve me përmbajtjen e paragrafëve duke i stimuluar të tregojnë, për kontributin e tyre në mirëmbajtjen e rregullit dhe pastërtisë në shtëpi dhe në shkollë.

Përmes diskutimit, nxënësit në bashkëpunim me mësuesin/en plotësojnë tabelën e mjeteve të pastrimit.

Hapi 4

Pasi morën informacione, nxënësit plotësojnë tabelën e mëposhtme.

- Si mund të kontribuojnë ata në mirëmbajtjen e higjienës në shtëpi dhe në shkollë?

Unë kontribuoj në shtëpi duke…	Unë kontribuoj në shkollë duke…

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes gjatë eksperimentit Plotësimi i tabelës me mjetet e higjienës Deklaratat për kontribut në pastrimin në shtëpi dhe shkollë.
Detyrë shtëpie
Detyrë në grup (afatgjatë): Bëj një projekt (planifikim) të thjeshtë në grup "Pastërtia gjysma e shëndetit" (Nxënësit në grupe të vogla me nga 3-4 nxënës bashkëpunojnë dhe krijojnë vizatime me mesazhe për higjienën).

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Kujdesi ndaj ambientit dhe ruajtja e shëndetit			
Rezultati i të nxënit të temës: Përdor në mënyrë të drejtë veglat për punë.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3; **III.** 2, 3, 7; **IV.** 5, 6; **V.** 1, 5, 7; **VI.** 2 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.** 2; **3.** 2; **6.** 1; **8.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
2.4-5 Njësia mësimore: Projekt: Krijoj modele të ndryshme	**Fjalët kyçe**: higjienë, kujdes, shëndet, projekt, projekto, përdor, pres, lidh, krijim.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - përgjigjet saktë - përdorë në mënyrë - projekton idenë - krijon punime - DRTA - Stuhi mendimesh - Turi i galerisë - Vizualizimi - Ditari dypjesësh - Gushëkuqi rrethor - Pyetje binare - Rrjeti i diskutimit - Mësimdhënia e ndërsjellë - Mësimdhënia dhe të nxënët me fëmijën në qendër dhe gjithëpërfshirja. - Të nxënët përmes lojës. - Mësimdhënia dhe të nxënët e integruar. - Mësimdhënia dhe të nxënët bazuar në arritjen e kompetencave. - Të mësuarit përmes projekteve. - Të mësuarit përmes hulumtimit. ***Kriteret e suksesit:*** Puno me kujdes me veglat e punës. Bashkëpuno në realizimin e projektit. Ndërto punime kreative me materialet në dispozicion.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, burime nga interneti (*https://www.pinterest.com/pin/281543706987588/*), mjetet dhe materiale të ndryshme të punës, lidhëse këpucësh, pambuk, shkopinj druri, modele të ilustrimeve, projektori.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukate figurative, Shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Mësimi fillon me kuicin "Elimino mikrobet". Nxënësit ndahen në 4 skuadra, dhe para tyre paraqitet mikrobet të vizatuar në 5 hamerë (letra në format B2) dhe të ndarë në 5 pjesë. Mësuesi/ja ka përgatitur 5 pyetje që kanë të bëjnë me higjienën personale. Përgjigjja e saktë eliminon një pjesë të mikrobeve dhe skuadra që përgjigjet saktë, merr 1 pikë. Kështu vazhdohet derisa eliminohen të gjitha mikrobet.

Pse duhet mirëmbajtur higjiena personale?

Ku janë të pranishme më shumë mikrobet?

Çfarë ndodhë nëse nuk kujdesemi për higjienën personale?

Si duhet eliminuar mikrobet?

Cili është mesazhi juaj për mikrobet?

Hapi 2

Nxënësit njihen me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore.

Ata duhet të ndahen për projektin që do ta realizojnë në grup, që ka të bëjë me higjienën personale.

Nxënësit do ta paraqesin punën e tyre duke ilustruar në mënyrë kreative figurat, duke u bazuar në shembujt në libër apo shembujt që do të paraqes mësuesi/ja në projektorë (*https://www.pinterest.com/pin/281543706987588/*)

Materialet e nevojshme: Letër vizatimi, letër me ngjyra, karton, gërshërë, lapsa me ngjyra, lapustila, ngjitëse, shkopinj druri, pambuk, lidhëse këpucësh, modele ilustruese, videoprojektor.

Nxënësit bëjnë ndarjen e përgjegjësive në grup (gjithnjë nën vëzhgimin e mësuesit/es). Çdo nxënës duhet të ketë rolin e tij, në mënyrë që kur bëhet prezantimi i projektit, secili shpjegojë punën e vet kreative.

Hapi 3

Secili grup prezanton punimet para klase, në një kënd të quajtur "Pastërtia, gjysma e shëndetit". Në varësi të aftësive që kanë nxënësit, projekti i tyre mund të përbëhet prej disa punimeve që mund të përzgjedhin nga shembujt në libër apo ato nga interneti (referojuni hapit të dytë).

(Pas trajtimit të temës "Higjiena" sugjerohet që nxënësit të dërgohen për vizitë në ambulancën më të afërt të shkollës.)

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes gjatë kuicit Përdorimi i mjeteve të punës Kreativiteti nëA punën praktike
Detyrë shtëpie
Puno në shtëpi një shembull të tillë dhe sjell në këndin e klasës "Pastërtia gjysma e shëndetit".

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Trafiku			
Rezultati i të nxënit të temës: Dallon rregullat e sjelljes si bashkudhëtarë në mjetet e trafikut**.**	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3; **II.** 1, 5, 7; **III.** 2, 3, 6; **IV.** 3, 4; **VI.** 3, 6, 7 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.** 1, 2; **6.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
3.1 Njësia mësimore: Siguria në rrugë	**Fjalët kyçe**: Rregulla, trafik, polici, shenja komunikacioni, semafor, vija të bardha.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore ***Nxënësi/ja:*** - dallon rëndësinë e respektimit të rregullave në trafik përmes lojës; - analizon me kujdes shenjat e trafikut në rrugë; - vizaton trafikun rrugorë duke u bazuar në vëzhgimet e bëra. ***Kriteret e suksesit:*** Thuaj arsyen e zbatimit të rregullave në trafik. Identifiko shenjat e komunikacionit në ilustrim. Vizato trafikun rrugorë duke u bazuar në vëzhgimet e bëra.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, trafiku rrugorë, ilustrimet, organizuesi grafik.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Mësuesja/si propozon një lojë (Udhëtimi me makinë) ku nuk ndiqet asnjë rregull, mund të jetë thjeshtë pyetje kuici, nxënësit mund të kopjojnë, të bëjnë hulumtim në libra etj. Pra nuk u thuhet asgjë, ata mund të veprojnë si të duan pa asnjë rregull. Në momentin që nxënësit fillojnë të ankohen për parregullsitë, loja apo kuici ndalet dhe nxënësit reflektojmë së bashku.

- Çfarë ndodhi gjatë lojës?
- Pse ndodhi një gjë e tillë?
- Çfarë do të ndodhte nëse nuk do të kishte rregulla në rrugë?
- Pse mendoni sa janë të rëndësishme rregullat në rrugë?

Në këtë mënyrë arrijmë te tema që do të trajtohet “Siguria në rrugë”.

Hapi 2

Hapen librat dhe analizohen situatat duke nxitur nxënësit të zotohen në respektimin e rregullave dhe shenjave të trafikut në rrugë, respektimin e sinjaleve të punonjësit të policisë rrugore (nxënësit njihen me detyrat dhe përgjegjësit e policit rrugorë), kalimin e rrugës në vijat e bardha dhe respektimin e semaforit.

- Cilat nga rregullat e mësipërme janë të njohura për ju?
- Po të panjohura?
- Si duhet të ecim që të jemi të sigurt për jetën tonë?
- Si duhet të veprojmë kur nuk jemi të sigurt, kujt t'i kërkojmë ndihmë?

Hapi 3

Nxënësit afrohen në dritaren e klasës (mund të dalin në rrugë së bashku me mësuesin/en) dhe vëzhgojnë me kujdes rrugën. Më pas kthehen në vendet e tyre (klasë) dhe vizatojnë atë që kanë parë në rrugë. Pasi e kanë kryer detyrën, u kërkohet të bëjnë krahasimin me shokun në krah dhe të thonë sa gjëra të njëjta kanë parë. Pas kësaj, nxënësit e plotësojnë punimin me elemente të tjera duke vëzhguar trafikun rrugës për në shtëpi. Punimet e plotësuara me elementet e tjera të trafikut, nxënësit do t'i sjellin në klasë dhe do t'i analizojnë me shokët dhe mësuesin/en.

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes *në hapin e parë* dhe të dytë. Sqarimi i rregullave dhe shenjave të komunikacionit përmes vizatimit.
Detyrë shtëpie
Plotëso vizatimin që ke punuar në klasë me elemente të tjera të trafikut duke vëzhguar rrugës për në shtëpi. Sille në klasë për ta analizuar.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Trafiku			
Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon rrugët rreth shkollës, shenjat e shtigjeve për këmbësor dhe **çiklistë**.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3; **II.** 1, 5, 7; **III.** 2, 3, 6; **IV.** 3, 4; **VI.** 3, 6, 7 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.** 1, 2; **6.** 1; **8.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
3.2 Njësia mësimore: Shenjat e qarkullimit rrugor	**Fjalët kyçe**: Shteg, këmbësor, zebra, shtegu i çiklistëve, vija të bardha, rrugë e hapur, semafor, sinjale.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - identifikon shenjat/shtigjet që ka parë rrugës për në shkollë në ilustrimin e librit; - dallon shtigjet e këmbësorëve/makinave/biçikletave dhe shenjat e rrezikut gjatë lojës; - krijon kubin prej letre duke u bazuar në instruksionet e dhëna. ***Kriteret e suksesit:*** Veço shenjat/shtigjet që ka parë rrugës për në shkollë. Thuaj shtigjet e këmbësorëve/makinave/biçikletave dhe shenjat e rrezikut. Krijo kubin prej letre duke u bazuar në instruksionet e dhëna.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Informata nga interneti, libri i nxënësit, ilustrimet, fletë A4, zare, kub, gërshërë, ngjitës letre.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Edukatë fizike, sporti dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Luhet loja me zare ku secili nxënës ka para letër dhe laps. Nxënësi i parë hedh zarin dhe vizaton atë pjesë të semaforit që përkon me numrin (nëse i bie i njëjti numër, zari kalon te nxënësi tjetër, do të thotë që e humb radhën). Nxënësi që arrin të vizatoj i pari semaforin, fiton lojën (Numri 1 trupin e semaforit, numri 2 mbajtësen, numri 3 sinjalet, numri 4 trupin e semaforit të këmbësorëve, numri 5 mbajtësen, numri 6 sinjalet e semaforit)

Kur nxënësi fitues ta ketë vizatuar semaforin, e tregojmë para klasës dhe shtrojmë pyetjet:

- Çfarë na tregon semafori në rrugë?
- Kur duhet të ndalojmë/presim/ecim?
- Çfarë ndodhë nëse nuk e respekton semaforin?
- Ku është dallimi mes dy semaforëve në figurë? Ku ndryshojnë dhe ku ngjasojnë ata?
- Sa i rëndësishëm është për ju semafori në rrugë?
- A e respektoni sinjalin e semaforit? Si veproni?

Hapi 2

Nxënësit paraqesin vizatimin që kanë pasur për detyrë (të plotësojnë me elemente shtesë të trafikut gjatë rrugës për në shtëpi). Mësuesja/si pyet nëse kanë parë semaforë rrugës për në shtëpi, gjithashtu u kërkon që të krahasojnë punimin e tyre me figurat në libër. Cilat elemente të vizatimeve të tyre janë në libër e cilat jo (diskutohet).

Në rrugë lëvizin makinat, biçikletat dhe njerëzit. Ku duhet që të lëvizin ata (njerëzit, makinat, biçikletat), që të jenë të sigurt?

Në këtë mënyrë, mësuesi/ja arrin të sqaroj se ku duhet të ecë njeriu, (vijat e bardha të këmbësorëve "zebrat"), makina (në mes të dy vijave të bardha në rrugë të hapur) dhe biçikleta (në shtegun e çiklisteve).

- Si ju duken tri shenjat e qarkullimit rrugor në libër?
- Si mendoni çfarë tregojnë ato?
- A ke parë shenja të tillë gjatë rrugës për në shtëpi? (nxënësit njihen me shenjat e rrezikut)

Në vazhdim, nxënësit analizojnë ilustrimin e fundit në libër dhe japin komentet e tyre.

Hapi 3

Secilit grup iu ofrohet nga një maketë e tillë si më poshtë. Nxënësve duhet ta presin dhe të formojnë kubin. Pasi hedhin kubin, foton që i bie duhet ta komentojnë përmes pyetjeve të mësuesit/es (fotot në kub mund të jenë të ndryshme për secilin grup. Nxënësit mund të krijojnë një tregim të shkurtër duke u bazuar në figura).

(Mësuesi/ja mund të ndërtojë një maketë të tillë të ngjashme si ajo më poshtë.)



Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes gjatë aktiviteteve Përgjigjet e sakta në pyetjet e shtruara Përdorimi i mjeteve të punës gjatë aktivitetit
Detyrat e shtëpisë
Hulumto (gjejë) dy shenja të rrezikut, ndryshe nga ato që mësove.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Trafiku			
Rezultati i të nxënit të temës: Sillet drejtë në trafikun urban	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3; **II.** 1, 5, 7; **III.** 2, 3, 6; **IV.** 3, 4; **VI.** 3, 6, 7 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.** 1,2; **6.** 1; **8.** 1		
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
3.3 Njësia mësimore: Veprimtari - Zbatimi i rregullave të qarkullimit rrugor	**Fjalët kyçe**: Shteg, këmbësor, zebra, shtegu i biçikletave, vija të bardha, rrugë e hapur, semafor, sinjale.		
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - diskuton për rregullat e trafikut gjatë ligjëratës së policit në klasë; - dallon shkeljen e rregullave të trafikut në organizuesin grafik; - plotëson saktë kërkesat e detyrave në libër. ***Kriteret e suksesit:*** Identifiko shkeljet e rregullave në trafik. Plotëso me saktësi detyrat në libër. Përdor me kujdes mjetet e punës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, libri i nxënësit, burime njerëzore, projektor, organizues grafik, ilustrim, maketë, gërshërë, ngjitës letre, ngjyrat e drurit.	**Lidhja me lëndët tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Edukatë figurative.		
Çështjet **ndërkurrikulare:** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Mësuesi/ja fton në klasë policin e trafikut, për t'u dhënë nxënësve informacione elementare për trafikun rrugor dhe njëkohësisht të krijoj raport miqësor polic-fëmijë (sipas mundësive, sugjerohet të bëhet një vizitë në stacionin e policisë), ose t'i referohet *link*-ut (*https://www.youtube.com/watch?v=VorVTs1esLQ*) (mësuesi/ja, mund të njihet paraprakisht me përmbajtjen e *link*-ut).

Hapi 2

Pas diskutimit dhe informimit nga polici i trafikut në klasë, secilit grup i ofrohet një ushtrim me situata të ndryshme të trafikut rrugor. Atyre u kërkohet që të analizojnë dhe të diskutojnë kërkesën e detyrës. Kërkesat e Organizuesve grafikë kanë të bëjnë me sjelljet e fëmijëve në trafik. Nxënësit duhet të dallojnë shkeljen e rregullave të trafikut.

(Mësuesi/ja mund të bazohet në situatat e mëposhtme)

Hapi 3

Hapen librat dhe pasi nxënësit të kenë marrë informacione të mjaftueshme u kërkohet që në mënyrë individuale të plotësojnë detyrat e dhëna në libër, duke dalluar sinjalet e semaforit, shtegun e biçikletave, shenjat e këmbësorëve dhe duke diskutuar veprimet në figurë (kush i zbaton rregullat e qarkullimit dhe kush jo). Mësuesi/ja jep vlerësim me shprehje nxënësve (vlerësimin përshkrues) për punën e bërë.



Hapi 4

Aktivitete në maketë.

Materialet e nevojshme: Gërshërë, ngjitës letre, maketa, fotografi me shenja të qarkullimit rrugor, laps, lapsat me ngjyrë.

Nxënësit punojnë në grup duke prerë, vizatuar dhe vendosur shenjat aty ku mendojnë që duhet vënë (duke u bazuar në rezultatet e pritura nxënësit nuk gjykohen për pasaktësi në plotësim të maketës). Punimet e nxënësve ekspozohen në murin e klasës (Punimet mund të vazhdohen edhe në orën e ardhshme, nëse nuk mjafton koha.



Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes Plotësimi i detyrave me saktësi në libër dhe në organizuesin grafik Përdorimi i mjeteve të punës gjatë aktivitetit
Detyrë shtëpie
Vizato udhëkryqin me elementet që duhet të ketë.

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna</td><td>Lënda: Shkathtësi për jetë</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: I</td></tr>
<tr><td colspan="4">Tema: Trafiku</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon rrugët rreth shkollës, shenjat e shtigjeve për këmbësorët dhe çiklistët.</td><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; II. 1, 5, 7; III. 2, 3, 6; IV. 3, 4; VI. 3, 6, 7</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 2; 6. 1; 8. 1; 9. 1</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="2">3.4-5 Njësia mësimore: Projekt: Çfarë më bën qytetar</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: Projekt, këmbësor, zebra, shtegu i biçikletave, vija të bardha, rrugë e hapur, semafor, sinjale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:
- plotëson saktë detyrën;
- organizon punën në grup duke bashkëpunuar me anëtarët e grupit.

Kriteret e suksesit:
Ngjyros/trego me saktësi shenjat e trafikut në libër.
Bashkëpuno me anëtarët e grupit në planifikimin e projektit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, libri i nxënësit, projektor, ilustrim, karton, shkopinj nga ata të akulloreve, gazeta, tapa shishesh, plastelinë, ngjyra uji, ngjyra druri etj.</td><td colspan="2">Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Edukatë muzikore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
</table>

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Mësuesi/ja i referohet *link*-ut (*https://www.youtube.com/watch?v=f7Jrp8RIzg4*) në të cilin përmes këngës nxënësit dëgjojnë dhe shohin mënyrën më të sigurt për të kaluar rrugën.

Hapi 2

Lojë në oborrin e shkollës ku mësuesi/ja kërkon që nxënësit të vizatojnë shenja të qarkullimit rrugor (vizatim në dysheme me shkumës me ngjyrë, shenjat e mësuara dhe vijat e bardha). Luhet loja në skuadra "Cila skuadër do të respektoi rregullat e trafikut", duke u bazuar në njohuritë e marra në videon që nxënësit panë në pjesën hyrëse të orës "Si duhet të kaluar rruga në trafik". Skuadra, anëtaret prej së cilës të gjithë kanë respektuar rregullat në trafik është fituese.

Hapi 3

Hapen librat, ngjyrosen shenjat e trafikut rrugor, sqarohen dhe diskutohen kërkesat për projektin e trafikut rrugor që nxënësit do ta punojnë në grupe. Mësuesi/ja sqaron termat e mëposhtëm dhe u kërkon nxënësve të bëjnë planifikimin në bashkëpunim.

- Caktimi i temës
- Ndarja e përgjegjësive
- Materialet e nevojshme
- Finalizimi i projektit

Nxënësit fillimisht ndahen në grupe, caktojnë temën, ndajnë përgjegjësitë, duke u bazuar në figurat në libër apo duke hulumtuar në internet (me ndihmën e mësuesit/es), diskutojnë për materialet e nevojshme (karton, shkopinj akulloreje, gazeta, tapa shishesh, plastelinë, ngjyra ujit, ngjyra druri etj.) dhe caktojnë kohën përfundimit të projektit. Ata nxiten që ta paraqesin projektin e tyre në mbledhjen e prindërve ose mund t'i ekspozojnë punimet edhe në festën e shkollës. Nxënësit fillojnë punën me materialet ekzistuese në klasë për të vazhduar punimet orën tjetër.

Modelet e mundshme nga interneti, përveç atyre në libër, janë si në vijim.

https://www.pinterest.com/pin/52776626861926830/
https://www.youtube.com/watch?v=1p4ItRZmKAk

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes Plotësimi i saktë i detyrës së dhënë
Detyrë shtëpie
Hulumto në internet (me ndihmën e prindit) ide për punimin e projektit sipas përgjegjësive që ke marrë.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre			
Rezultati i të nxënit të temës: Dallon vetitë elementare të materialeve nga jeta e përditshme dhe mënyrat e përpunimit të tyre.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 1, 4, 7; **III.** 1, 2, 6; **IV.** 2, 5; **V.** 2; **VI.** 2, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.** 1; **3.** 2; **8.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
4.1 Njësia mësimore: Përdorimi i materialeve në jetën e përditshme	**Fjalët kyçe**: Material, dru, plastik, qelq, qeramikë, përpunim.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - dallon llojet e ndryshme të materialeve; - përshkruan vetitë elementare të materialit; - gjen materialet e ndryshme të objekteve në klasë. ***Kriteret e suksesit:*** Thuaj saktë materialin e objektit që ke zgjedhur në shportë. Dallo vetitë elementare të materialit në ilustrim. Emërto saktë materialin e objektit që ke gjetur.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, Libri i nxënësit, Organizuesi grafik, objekte të materialeve të ndryshme.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare: Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Ora mësimore fillon me aktivitetin "Çfarë është".

Nxënësit qëndrojnë ulur në rreth, mësuesja/si u ofron shportën me objekte të ndërtuara me materiale të ndryshme (pjata dhe tasa plastikë, mbajtëse lapsash prej qeramike, ambalazh kartoni i plastifikuar, vizore druri, shishe uji prej qelqi, kukull) dhe u kërkon të gjejnë përmes prekjes, çfarë kanë në dorë:

- Çfarë ke në dorë?
- Nga se është e ndërtuar?
- Për çfarë shërben?
- Si është, e butë apo e fortë?
- Është e lëmuar apo e vrazhdë?

Hapi 2

Të gjitha objektet që ishin në shportë ekspozohen para klasës dhe mësuesja/si shtron pyetjet:

- Ç'formë ka? Cilat janë përmasat? Ç'ngjyrë ka?
- Me kë ngjason? Nga se ndryshon?
- *Çfarë ju bën të mendoni në këtë mënyrë*? Çfarë ju vjen në mendje?
- Si është ndërtuar? Nga se përbëhet?
- *Ç'mund të bëni me të? Si mund të përdoret?*
- Cili është qëndrim juaj sa janë të nevojshme në jetën e përditshme materialet e tilla? Pse?

Hapi 3

Hapen librat dhe nxënësit njihen me temën që po trajtohet. Mësuesja/si i orienton nxënësit te fotot dhe u kërkon të thonë se çfarë dinë për objektet që shohin. Pas diskutimit dhe shqyrtimit të informacioneve nga libri, mësuesja/si kërkon nga nxënësit të gjejnë në klasë objekte me materiale të ndryshme të tilla si ato që u trajtuan.

Mësuesi/ja i orienton nxënësit tek fotot në libër. Ata duhet të qarkojnë tri nga objektet që shohin dhe të gjejnë materialin me të cilin janë punuar.

Hapi 4

Për të zgjeruar njohuritë për materialet dhe për ta bërë më atraktive temën për nxënësit, mësuesi/ja vendos në sfond (projektorë) këngën për materialet e shoqëruara me imazhe të llojeve të materialeve të ndryshme. (*https://www.youtube.com/watch?v=xOKr462HLc0*)

Hapi 5 (me zgjedhje)

Luhen lojëra të ndryshme (prej materialeve të ndryshme) si:

- Domino (prej druri)
- Njeri mos u hidhëro (karton dhe plastikë)
- *Bowling* (plastikë)
- Letra bixhozi (letër)

Çfarë materiali kanë lojërat që luani? (Druri, plastike, kartoni, letër)

Mësuesja/si paraqet organizuesin grafik, nxit nxënësit të formojnë kamionin duke përdorur gërshërë dhe të shkruajnë llojin e materialit që kanë objektet në kamion. Mësuesi/ja pyet edhe për strukturën dhe materialin e pjesëve të kamionit. (Shënim: Mësuesi/ja mund të modelojë kamionin duke ndjekur modelin e mëposhtëm.)

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes – Analiza përmes lojës e llojeve të materialeve Saktësia e llojit të materialit të punuar në detyrë Prerja dhe plotësimi pa gabime i organizuesit grafik
Detyrë shtëpie
Prit gazeta me objekte të materialeve të ndryshme dhe silli ato në klasë.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre			
Rezultati i të nxënit të temës: Klasifikon materialit sipas llojit, vetive, ngjyrës etj.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 1, 4, 7; **III.** 1, 2, 6; **IV.** 2, 5; **V.** 2; **VI.** 2, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.** 1; **3.** 2; **8.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
4.2 Njësia mësimore: - Klasifikimi i materialeve	**Fjalët kyçe**: material, metal (alumini, çeliku, inoks), jometal (druri, qelqi, qeramika, plastika)
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - dallon objektet me materiale metali nga jometali; - shpjegon vetit e metaleve dhe jometaleve; - argumenton njohurit duke plotësuar saktë kërkesat në kuic. ***Kriteret e suksesit:*** Klasifiko saktë metalet nga jometalet. Trego disa veti të materialit që ke zgjedhur. Plotëso me saktësi kërkesat e detyrave në kuic.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, objektet në klasë, fletë A4, ngjyrat etj.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për zhvillim të qëndrueshëm	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Aktivitete "Pikat e shiut"

Nxënësit duhet të kenë pranë vetes lapsat me ngjyrë dhe një fletë A4. Atyre u kërkohet që sa herë dëgjojnë zhurmën e shiut në magnetofon, ata duhet të bëjnë nga një pikë (pikat e shiut), duke filluar me një ritëm të ngadaltë dhe më pas e përshpejtojnë atë. Në momentin që zhurma ndalon, nxënësit ndërrojnë ngjyrë. Ky aktivitet vazhdon derisa nxënësit mbushin fletën me pikat shumëngjyrëshe të shiut. Në vazhdim, nxënësit sipas imagjinatës duhet të lidhin pikat për të krijuar një apo dy objekte. Hapet diskutimi në klasë përmes pyetjeve.

- Çfarë figure keni krijuar?
- Nga se ndërtohet objekti (figura) që keni krijuar në fletën tuaj?
- A mund t'i grupojmë objektet që krijuat në metale dhe jo metale? Si do ta bënit këtë?

Hapi 2

Përmes trungut të mendimeve, mësuesi/ja merr informacion nga nxënësit për njohuritë që kanë për materialet metalike dhe jometalike.

Hapi 3

Nxënësit njihen me njësinë mësimore, bëhet leximi i tekstit me ndalesa nga mësuesi/ja ku pas secilës ndalesë pyet:

- Cilat janë llojet e materialeve?
- Ku e dallon materialin e metalit nga jometali?
- Cilat janë vetitë e tyre?
- Si mundë t'i dallojmë vetitë e tyre? (duke i parë dhe prekur)
- Pse veglat e riparimit janë prej metali?
- Pse zgjidhet material druri/plastike për karriget dhe jo metali?

Hapi 4 Punë në grupe në formë kuici.

Detyra e parë është të bëhet një hetim në klasë rreth objekteve ekzistuese. Nxënësit duhet të thonë janë metale apo jometale dhe do të japin argumentet për përgjigjet që kanë dhënë. Si detyrë e dytë u kërkohet të mbyllin sytë për një çast dhe të kujtojnë objekte nga kuzhina e shtëpisë që janë prej metali dhe jometali (grupi që thotë më shumë përgjigje të sakta fiton pikë). Në përfundim, grupet duhet të plotësojnë tabelën e mëposhtme duke vendosur një shenjë në kutizë për përgjigjen e saktë.

	Metal	Jometal	I rëndë	I lehtë	I tejdukshëm

(Kuici mund të realizohet edhe përmes programeve të ndryshme kompjuterike.)

Vlerësimi i nxënësve
Hetimi dhe analiza e materialit. Përgjigjet e sakta në pyetjet e shtruara. Plotësimi i tabelës pa gabime.
Detyrë shtëpie
Shkruaj (vizato) një objekt prej metali dhe një prej jometali dhe trego vetitë e tyre.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre			
Rezultati i të nxënit të temës: Përdor gërshërët e disa mjete të tjera në mënyrë të drejtë.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3, 7; **II.** 5, 7; **III.** 7; **IV.** 3, 4, 5, 6; **V.** 1, 4, 7; **IV.** 6, 7 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.** 1; **3.** 2; **8.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
4.3 Njësia mësimore: Përdorimi i veglave të punës në jetën e përditshme	**Fjalët kyçe**: Mjete pune, kuti me vegla, çekiç, kaçavida, çelës anglez, sharra, pinca, trapan.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - thotë se çfarë di për mjetet e punës duke u bazuar në figurë; - përdor gërshërët e disa mjete të tjera në mënyrë të drejtë; - shpjegon funksionin e mjetit duke e shënuar në kartë. ***Kriteret e suksesit:*** Thuaj dy-tri mendime rreth ilustrimit. Puno mjetet e punës me materialet në dispozicion. Sqaro funksionin e mjetet të punës që ke punuar.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, karton, gërshërë, ngjyra, ngjitës letre, tiketa të vogla kartoni, mostër mjetesh të punës, mjete pune plastike (lodër).	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësi për jetë.	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Mësuesja/si paraqet figurën para nxënësve dhe u kërkon të thonë se çfarë iu vjen në mendje kur e shikojnë.

Nxënësit thonë mendimet e tyre, mësuesja/si shënon ato në tabelë pa i gjykuar.

- Çfarë ju vjen në mendje kur shikoni figurën?
- Çfarë mban në duar djali në figurë?
- Cilat prej mjeteve janë metale/jometale?
- Pse është paraqitur në këtë formë?
- Kë ju kujton ai? Pse?



Hapi 2

Mësuesi/ja u ofron nxënësve materiale të thjeshta për të krijuar mjetet e punës (karton, gërshërë, ngjyra, lapustil, ngjitës letre, copa të vogla kartoni, mostër mjetesh të punës) si dhuratë për babin. Nxënësve u ofrohen udhëzime për punën praktike.



Hapi 3

Pasi nxënësit kanë ndërtuar veglat, mësuesi/ja kërkon që secili prej tyre t'i prezantojë përpara shokëve/shoqeve dhe tregon funksionin e saj.

Hapi 4

Nxënësit vazhdojnë punën praktike duke shtuar mjetet e punës dhe duke u vendosur nga një kartë me emrin e mjetit dhe funksionin e tij. Të gjitha punimet e nxënësve ekspozohen në klasë.

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes *në hapin e parë* Përgjigjet e sakta gjatë zhvillimit të njësisë Përdorini i drejtë i mjeteve të punës gjatë punës praktike
Detyrë shtëpie
Hulumto në internet për mjetet e thjeshta të punës dhe reflekto në klasë për përdorimin e tyre.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre			
Rezultati i të nxënit të temës: Përdor gërshërët e disa mjete të tjera në mënyrë të drejtë.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3, 7; **II.** 5, 7; **III.** 7; **IV.** 3, 4, 5, 6; **V.** 1, 4, 7; **IV.** 6, 7 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.** 1; **3.** 2; **8.**		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
4.4-5 Njësia mësimore: Projekt: Krijoj objekte të thjeshta për shtëpi ose klasë	**Fjalët kyçe**: Projekt, materiale, metal, jometal, mjete pune.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - zbulon materialin duke u bazuar në vetitë që thotë gjëegjëza; - krijon objektin e zgjedhur me materiale të ndryshme; - arsyeton përzgjedhjen e materialit për krijimin e objektit. ***Kriteret e suksesit:*** Gjej cili material është duke u bazuar në vetitë e tij. Puno një objekt me materiale të ndryshme ricikluese. Shpjego krijimin tënd para klasës.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, burime nga interneti (***https://www.pinterest.com/pin/AdAJtH724JZDwO466MywLlBHVHMJ4_ogM9oGJYBqfDupHc72eVufI1U/***), Letër/karton A4, letër me ngjyra, gërshërë, ngjitës, lapsa me ngjyra, gotë/pjata plastike, shkopinj druri akulloreje, tapa shisheje, pulla plastike.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore**: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësi për jetë	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Ora mësimore fillon me gjëegjëza kushtuar materialeve që kemi trajtuar deri më tani, ku në bazë të ca vetive të materialeve, nxënësit duhet të dinë për cilin material flitet. Nxënësit të ndarë në katër grupe do të garojnë për të gjetur llojin e materialit.

Kush është? Rritet në pyll, E godasim me gozhdë, E përdorim për ngrohje, Ndërtojmë mobilie.	**Kush është?** Është e tejdukshme, Thyhet lehtë, Depërton dritën e diellit në dhomë.

Kush është? Është i fortë, Ka shkëlqim, Ka ngjyrë dielli, Shërben për stoli. 	**Kush është?** Është e lehtë, Shqyhet lehtë, Digjet lehtë, Shërben për të shkruar.

Hapi 2

Hapen librat, nxënësit njihen me punën praktike (projekte të thjeshta) që do të bëjnë në bashkëpunim me grupin. Ata orientohen të vrojtojnë shembujt në libër dhe në projektor. Mësuesi/ja paraqet shembuj të përdorimit të materialeve të ndryshme për krijimin e objekteve, në mënyrë që të nxit kreativitetin te nxënësit. Mësuesi/ja përcakton objektin që do të krijojë çdo grup. Ofrohen materialet e nevojshme për punë si: Letër/karton A4, letër me ngjyra, gërshërë, ngjitës, lapsa me ngjyra, gotë/pjata plastike, shkopinj druri akulloreje, kapakë shishe, pulla plastike.

Hapi 3

Para se të fillojnë punë praktike, nxënësit nxiten të diskutojnë për materialet që kanë, llojin e materialit dhe vetitë. Mësuesi/ja i orienton nxënësit te makina larëse e rrobave dhe abazhuri që të reflektojnë për përbërjen e materialeve me të cilat ato ndërtohen.

Hapi 4

Mësuesja/si ndihmon secilin prej grupeve me sugjerime dhe udhëzime e njëkohësisht vlerëson kontributin e secilit nxënës gjatë punës në grup.

Punimet e nxënësve ekspozohen në këndin e artit dhe diskutohen.

- Çfarë objekti keni krijuar?
- Cilat materiale keni përdorur?
- Pse zgjodhët pikërisht atë material?

Nxënësit reflektojnë përmes diskutimit në klasë për punën që kanë bërë.

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes *në aktivitete*. Përdorimi i mjeteve të punës gjatë realizimit të projektit. Vlerësimi i ndërsjellët *në mes nxënësve*. Paraqitja e projektit në grup (prezantimi) në pjesën përfundimtare të orës mësimore.
Detyrë shtëpie
Ndërto një objekt të thjeshtë me materialet që ke në shtëpi dhe sille në klasë.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës:** I	**Klasa:** I
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre			
Rezultati i të nxënit të temës: Dallon vetitë elementare të materialeve nga jeta e përditshme dhe mënyrat e përpunimit të tyre.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3, 7; **II.** 4, 7; **III.** 7; **IV.** 3, 5, 6; **V.** 5, 7; **VI.** 2, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
4.6 Njësia mësimore: Kontrollo përparimin	**Fjalët kyçe:** Materiale, mjetet e riparimit, shenjat e qarkullimit rrugor
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - emërton drejtë së paku tri vegla të riparimit/dy shenja të qarkullimit rrugor në ilustrim; - shpjegon saktë materialet me të cilat janë prodhuar objektet në shembullin e dhënë; - argumenton vlerësimin e bërë të shokut në krah. ***Kriteret e suksesit:*** Shkruaj drejtë veglat e riparimit dhe shenjat e qarkullimit rrugor. Trego saktë materialet me të cilat janë prodhuar objektet. Arsyeto vlerësimin që i ke bërë shokut në krah.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, organizuesi grafik	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, shoqëria dhe mjedisi
Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1

Ora fillon me njohjen e nxënësve për punën individuale që do të bëjnë për të kontrolluar përparimin e tyre (vetëvlerësim) gjatë trajtimit të temës “Materialet dhe përpunimi i tyre”.

Hapi 2

Hapen librat dhe mësuesja/i sqaron kërkesat e detyrave dhe diskuton për veprimet që nxënësit duhet të bëjnë.

Nxënësit në mënyrë të pavarur duhet të emërtojnë veglat e riparimit, të tregojnë me çfarë materialesh janë prodhuar objektet në fotografi dhe të emërtojnë shenjat e qarkullimit rrugor.

Përmes "Semaforit", nxënësi/ja tregojnë nëse e kanë të qartë çfarë duhet bërë. E kuqe (nuk kuptoj), ngjyrë portokalli (kuptoj pjesërisht), E gjelbër (kuptoj).

Hapi 3

Pasi nxënësit përfundojnë detyrën, shkëmbejnë librat me shokun në krah dhe bëjnë vlerësimin e ndërsjellë "Dy yje një dëshirë". Mësuesi/ja vëzhgon punën e nxënësve dhe ndihmon nëse është e nevojshme.

Nxënësit në fund reflektojnë për punën dhe vlerësimet që kanë bërë.

Vlerësimi i nxënësve
Plotësimi pa gabime i organizuesit grafik në libër. Vlerësimit i ndërsjellë "Dy yje një dëshirë".
Detyrë shtëpie

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Profesionet			
Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan profesionet e prindërve dhe të afërmve të tij.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 6; **II.** 1, 3, 7, 8; **III.** 1, 2, 3, 4; **IV.** 4, 5; **V.** 5; **VI.** 2, 4, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.** 1; **3.** 1, 2; **4.** 1; **7.** 1		
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
5.1 Njësia mësimore: Profesionet e familjarëve të mi	**Fjalët kyçe**: Profesion (lloje të ndryshme të profesioneve), anëtarë të familjes, familje e vogël/e madhe.		
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - formon figurën e duhur duke bashkuar copëzat e letrës; - dallon llojet e profesionit duke dhënë sqarimet e nevojshme; - plotëson saktë detyrën e dhënë duke bërë lidhjen e profesionit me mjetet e nevojshme. ***Kriteret e suksesit:*** Ngjit copëzat e fletës për të krijuar figurën. Gjej të ngjashmëritë dhe ndryshimet e profesioneve në fjalë. Lidh me shigjetë profesionin me mjetin e nevojshëm.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, organizuesi grafik, fletë A4 (*puzzle*).	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi.		
Çështjet ndërkurrikulare: Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1.

Mësuesja/si ofron secilit grup nga një fletë A4 të ndarë në formë *e puzzle*-it, u kërkon nxënësve që të bashkojnë në grup figurën në ilustrim dhe të diskutojnë çfarë kanë formuar.

Secili grup paraqet ilustrimin para klasës. Përfaqësuesi i grupit tregon çfarë figure kanë krijuar.

- Çfarë figure keni krijuar?
- Kush është ky person?
- Çfarë pune bënë ai/ajo?
- Pse mendon ashtu, çfarë të shtyri të mendosh se ai është…?



- Si quhet puna me të cilën merret një person? (Profesion)
- Në këtë mënyrë arrijmë te koncepti i fjalës “Profesion”.

Hapi 2.

Hapen librat dhe nxënësit njihen me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit në mënyrë të tërthortë e me fjalë të thjeshta.

Hapi 3. *Hetim*

Mësuesi/ja u kërkon të shohin ilustrimet në libër dhe të gjejnë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes të ilustrimeve që kanë krijuar në hapin e parë, dhe atyre në libër.

- Çfarë profesioni ka babai/nëna?
- Ku ndryshon prej shembujve që kemi?

Në këtë mënyrë analizohen profesionet e paraqitura në libër.

Hapi 4.

Diskutohet:

- Në cilin profesion punojnë prindërit e tu?
- Po të afërmit?
- Përshkruani çfarë bëjnë ata në profesionin e tyre.

Hapi 5.

Në fund, nxënësit duhet të reflektojnë në mënyrë individuale duke plotësuar organizuesin grafik që u ofron mësuesja/si. Organizuesit grafik janë të ndryshëm 1-5, dhe të tillë u shpërndan nxënësve në grup (secili nxënës në grup ka organizuesin grafik të ndryshëm prej tjetrit).

(1)

(2)



(3)



(4)



(5)



Punimet e nxënësit vlerësohen me informatë kthyese nga shoku në krah përmes teknikës “Dy yje nj**ë dëshirë”.**

(Me zgjedhje për pjesën përfundimtare të orës: Nxënësit mund të shkruajnë apo të vizatojnë profesionet e familjarëve të tyre.)

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes gjatë aktivitetit të parë. Saktësia në shkathtësitë e komunikimit pyetje-përgjigje. Vlerësimi “Dy yje një dëshirë”. Informata kthyese në organizuesin grafik.
Detyrë shtëpie
Pyet prindërit/kujdestarin për profesionet e anëtareve të familjes së madhe.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Profesionet			
Rezultati i të nxënit të temës: Shpreh dëshirën e tij për profesionin që do të ndjekë kur të rritet.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 6; **II.** 1, 3, 7, 8; **III.** 1, 2, 3, 4; **IV.** 4, 5; **V.** 5; **VI.** 2, 4, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.** 1; **3.** 1, 2; **4.** 1; **7.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
5.2 Njësia mësimore: Kur të rritem, dua të bëhem...	**Fjalët kyçe**: Llojet e profesioneve (mjek, mësues, avokat, marangoz etj.), profesionalist.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - gjen dilemat e personazhit duke u bazuar në atë çka di për temën; - arsyeton me disa fjali përzgjedhjen e profesionit në të ardhmen; - krijon përmes punës praktike personazhin (vetveten) në profesionin që dëshiron. ***Kriteret e suksesit:*** Zbulo dilemat e personazhit në sfond. Thuaj arsyen e profesionit që pëlqen. Puno veten tënde në profesionin që imagjinon.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti (*https://www.pinterest.com/pin/850758804445106 38/*), libri i nxënësve, mjetet e punës (shkopinj druri, ngjitës letre, gërshërë etj.)	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë)	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1.

Mësuesi/ja paraqet në sfond (projektor) një ilustrim të tillë që jep të kuptoi dilemat për një çështje të caktuar.

Ai/ajo kërkon nga nxënësit që të bazohen në atë që kemi trajtuar orë e kaluar dhe të gjejnë dilemat e personazhit në fjalë (nxënësit në këtë mënyrë do të nxiten në të menduarit e thelluar për të gjetur zgjidhjen).

Hapet diskutimi, nxënësit thonë mendimet e tyre. Mësuesja/si orienton nxënësit (nëse është e nevojshme) te tema e profesioneve. Shtron pyetjen: Çfarë do të bëhesh kur të rritesh?

Hapi 2.

Përgjigjet që merr mësuesja/si nga nxënësit i paraqet në sfond (projektor), do të thotë profesionin që thonë (apo ilustrimi në libër). Trajtohen profesionet që thonë nxënësit por njëkohësisht lexohen informacionet në libër duke bërë lidhjen mes tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit marrin informatat elementare për profesionet të ndryshme si: Bankier, marangoz, murator, mjek, avokat. Pas diskutimeve, ata arrijnë në përfundim se, ajo që duhet të bëj është të mësoj shumë mirë të gjitha lëndët në shkollë, që të bëhet një profesionistë në profesionin që zgjedh.

Formohen grupet e nxënësve sipas profesioneve të pëlqyera si:

- grupi i mjekëve;
- grupi i mësuesve;
- grupi i marangozëve etj.

Secilit grup u ofrohet materiali i nevojshëm (shkopinj druri, ngjitës, gërshërë) për të punuar personazhin (vetveten) me profesionin e pëlqyer. Gjithashtu, në sfond (projektor) vendosen fotot për të nxitur ide për mënyrën si do të punojnë. (Me zgjedhje: secili nxënës mund të punojë personazhe të disa profesioneve.)

Vlerësimi i nxënësve
Gjetja e zgjidhjes në hetimin për personazhin me dilema. Argumentet në përzgjedhjen e profesionit. Krijimi i figurës së vet në profesionin e imagjinuar.
Detyrë shtëpie
Hulumto në internet për profesionin që pëlqen dhe sill informacionin në klasë.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Profesionet			
Rezultati i të nxënit të temës: Prezanton fotografi të ndryshme duke i identifikuar profesionet nga fotot		**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 6; **II.** 1, 3, 7, 8; **III.** 1, 2, 3, 4; **IV.** 4, 5; **V.** 5; **VI.** 2, 4, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.** 1; **3.** 2; **7.** 1	

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
5.3 Njësia mësimore: Veprimtari: Profesionet që njoh	**Fjalët kyçe**: Llojet e profesioneve (mjek, mësues, avokat, marangoz etj.), profesionalist.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - imiton veprime të profesioneve të ndryshme përmes lëvizjeve trupore; - argumenton punën që bënë njeriu në një profesion të caktuar; - vendos saktë tiketën në ilustrim për të fituar profesionin e përshtatshëm. ***Kriteret e suksesit:*** Gjej veprimet e duhura (ose gjej cili është) për një profesion të caktuar. Trego si kontribuon në shoqëri një profesion i caktuar. Plotëso pa gabime organizuesin grafik.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, mjetet e punës (ngjitës letre, gërshërë), organizuesi grafik.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Edukatë fizike sporti dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë)	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1.

Hapet diskutimi në klasë për njohuritë që nxënësit kanë marrë për profesionet. Mësuesi/ja u ofron tiketa me fjalë apo foto të profesioneve të ndryshme dhe kërkon nga nxënësit të sqarojnë profesionin përmes lëvizjeve trupore (mimikës). Pastaj bëjnë klasifikimin e tyre në tabelë duke treguar çfarë bën dhe cili është kontributi i profesionit në shoqëri.

Profesioni	Mjeku	Hidrauliku	Mësuesi/ja	Avokati
Çfarë bën?	Shëron njerëzit	Rregullon tubat e ujit	Mëson shkrim leximin	Mbron njerëzit sipas ligjit

Hapi 2.

Hapen librat, mësuesi/ja kërkon që të shohin ilustrimet dhe të shkruajnë (poshtë apo lart ilustrimit) cilin profesion e paraqet secili në figurë.

Hapi 3.

Hapet diskutimi:

- Pyet shokun/shoqen në klasë cilin nga këto profesione njeh?
- A punojnë të afërmit e tyre në ndonjë nga këto profesione?
- Janë të kënaqur me punën që bëjnë?

Nxënësit fillimisht diskutojnë në çifte për pyetjet e shtruara në libër. Në vazhdim, në mënyrë frontale diskutohet për profesionet e të afërmve të tyre, duke treguar për punët dhe angazhimin që kanë për të ushtruar profesionin në fjalë.

Hapi 4.

Në pjesën e fundit të orës (nëse ka kohë të mjaftueshme, nëse jo atëherë mbetet që detyra të kryhet në shtëpi) nxënësit në mënyrë individuale presin me gërshërë tiketen dhe e vendosin në vendin e duhur, për të rregulluar ilustrimin.

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes gjatë përsëritjes së njohurive. Listat e kontrollit. Plotësimi i saktë i organizuesit grafik.
Detyrë shtëpie
Pyet për profesionet që ushtrojnë familjarët e tu në familjen e madhe.

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna</td><td>Lënda: Shkathtësi për jetë</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: I</td></tr>
<tr><td colspan="4">Tema: Profesionet</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultati i të nxënit të temës: Vizaton veglat e ndryshme sipas profesioneve</td><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6; II. 1, 7; III. 1, 2, 3, 4; IV. 4, 5; V. 5; VI. 2, 4, 6</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2. 1; 3. 2; 7. 1</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="2">5.4 Njësia mësimore: Veprimtari: Vizatimi veglave sipas profesioneve</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: Profesione, mjek, mësues, avokat, marangoz, mjete, pajisje, sharrë, kaçavidë, vida, pinca, lopata etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:
- tregon për njohuritë e marra gjatë vizitës te marangozi;
- vizaton me kujdes të gjitha veglat dhe pajisjet e paraqitura në libër;
- emërton saktë veglat e punës së marangozit, hidraulikut dhe bujkut.

Kriteret e suksesit:
Trego çfarë ke parë dhe prekur te marangozi.
Vizato mjetet dhe veglat e punës të paraqitur në libër.
Thuaj me saktësi mjetet dhe veglat e punës që ke vizatuar.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, mjetet e punës, drejtëza numerike në dysheme.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: Profesione, mjek, mësues, avokat, marangoz, mjete, pajisje, sharrë, kaçavidë, vida, pinca, lopata etj.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë)</td></tr>
</table>

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1.

Bëhet një vizitë e shkurtër te marangozi (vizita mund të bëhet edhe te: bukëpjekësi, floktore, avokati) ku nxënësve u ofrohet mundësia të shohin punën dhe mjetet që ai përdorë për të ushtruar profesionin e tij. Nxënësit reflektojnë në klasë për bisedën me marangozin dhe atë çfarë kanë parë dhe prekur atje, për mjetet dhe procesin e punës.

Hapi 2.

Ora fillon përmes lojës, ku nxënësit duhet të numërojnë me hapa sa profesione njohin. Në raundin e dytë do të thonë sa mjete pune apo pajisje të profesionit të caktuar njohin. Grupi që thotë sa më shumë profesione dhe mjete apo pajisje, fiton lojën.

Hapi 3.

Hapen librat dhe nxënësit njihen me punën praktike që do të bëjnë dhe me materialet e nevojshme. Nxënësit duhet të vizatojnë mjetet e punës së profesioneve të ndryshme si p.sh., të: marangozit, hidraulikut, pajisjet e mjekut, veglat e bujkut dhe në fund mjetet e punës apo pajisjet e një profesioni që ata dëshirojnë.

Hapi 4.

Nxënësit vizatojnë në mënyrë individuale, dhe i paraqesin punimet e tyre para klasës. Mësuesi/ja nxitë nxënësit që të thonë emërtimet e mjeteve apo veglave të punës gjatë prezantimit të punës.

Vlerësimi i nxënësve
Emërtimi i llojeve të profesioneve dhe mjeteve/pajisjeve të profesioneve të caktuara. Vizatimi i mjeteve/pajisjeve të profesioneve të caktuara.
Detyrë shtëpie
Hulumto në internet dhe shkruaj pesë lloje të profesioneve. Vizato mjetet/pajisjet e tyre.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Profesionet			
Rezultati i të nxënit të temës: Përdorë kompjuterin për komunikim fillestarë, realizimin e ndonjë projekti të vogël (hulumtimi i fotografive, ruajtja e dokumentit).	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.** 1, 7; **III.** 2, 3, 4; **IV.** 4, 5; **V.** 5; **VI.** 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.** 1; **4.** 1		
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
5.5 Njësia mësimore: Mësoj më shumë për llojet e profesioneve	**Fjalët kyçe**: kompjuter/lap-top, internet, ikonë, informacion, miu, ekrani etj.		
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - tregon për njohuritë që ka në përdorimin e kompjuterit; - hulumton në internet për një informacion të caktuar; - shpjegon me saktësi hapat që duhet bërë për të hulumtuar informacione në internet. ***Kriteret e suksesit:*** Thuaj çfarë di për përdorimin e kompjuterit. Gjejë në internet informacione për një profesion që dëshiron. Sqaro hapat e bërë për të marrë informacionin nga interneti.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, kompjuter/lap-top, adresa të ndryshme interneti, skema e hapave të kërkimit.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Shoqëria dhe mjedisi.		
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për media			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1.

Ora mësimore mbahet në kabinetin e Informatikës TIK-ut (Me zgjedhje: në mungesë të kabinetit, ora mësimore mbahet në klasë, mësuesja/si sigurohet të ketë pranë kompjuter/lap-top).

Pasi të gjithë nxënësit janë sistemuar pranë kompjuterit/lap-top-it mësuesja/si hap diskutimin, duke i njohur fillimisht me ambientin e ri dhe me gjërat që ndodhen në kabinet.

- Si ju duket ky ambient?
- Çfarë ka këtu?
- E keni përdorur kompjuterin/lap-top-in?
- Për çfarë arsye?
- Si keni vepruar?
- Përveç se keni luajtur, a keni marr informacion nga interneti pa ndihmën e prindit për një detyrë të caktuar?
- Si?

Në këtë mënyrë, mësuesi/ja merr njohuritë paraprake për përdorimin e kompjuterit nga nxënësit.

Hapi 2.

Hapen librat dhe njëkohësisht, mësuesi/ja vë në sfond pamjen që kanë nxënësit në libër. Njëri nxënës lexon paragrafin e parë të tekstit.

- Çfarë kuptuat nga ajo që u lexua?
- Cili ishte hapi i parë i fëmijëve për të kërkuar informacione në internet?

Secilit grup mësuesja/si (apo edhe një nxënës që ka aftësi) i hap kompjuterin në faqen siç është në libër/ sfond dhe kërkon që ta dërgojnë miun në ikonën e duhur, atë të internetit.

Pastaj çfarë duhet bërë? (kërkojmë adresën *https://www.google.al/*)

Mësuesja/si inkuadron nxënësit të përgjigjen dhe të veprojnë në kompjuter, në mënyrë që të nxitë edhe nxënësit që nuk kanë fare provojë në përdorimin e kompjuterit.

- Cili është hapi tjetër? (nëse nxënësit nuk kanë përgjigje, mësuesja/si reagon duke dhënë sqarime dhe duke vepruar njëkohësisht në kompjuter).

Shkruani "Profesioni i mjekut" dhe klikoni "*Enter*" (që do të thotë "hyr") në faqen që ti ke zgjedhur.

Nxënësit veprojnë sipas udhëzimeve të mësuesit/es pa u gjykuar për veprimet. Në këtë mënyrë, mësuesi/ ja jep të gjitha informacionet elementare për të hulumtuar në internet për informacione që mund t'i nevojiten.

Hapi 3.

Hapat që duhet bërë për kërkimin në internet.

Hap kompjuterin dhe kliko në shenjën e internetit.

Pastaj kërko adresën: https://www.google.al/

Shkruaj **"profesioni i mjekut"** dhe kliko ***Enter***.

Nëse dëshiron **foto**, kliko te komanda ***Image***.

Hapi 4.

Secilit nxënës, mësuesi/ja u ka përgatitur një skemë të tillë si më lartë. Nxënësit në grupe kërkojnë në internet për profesionet që dëshirojnë. Informacionet e marra i paraqesin para klase.

Vlerësimi i nxënësve
Përdorimi i kompjuterit sipas udhëzimeve. Sigurimi i informacioneve nga interneti.
Detyrë shtëpie
Hulumto në internet një profesion dhe demonstroje para klasës si veprove.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Profesionet			
Rezultati i të nxënit të temës: Luan lojë me role për profesionin që ai dëshiron.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 6; **II.** 1, 3, 7, 8; **III.** 1, 2, 3, 4; **IV.** 4, 5; **V.** 5; **VI.** 2, 4, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.** 1; **3.** 1, 2; **4.** 1; **7.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
5.6-7 Njësia mësimore: Projekt: Profesioni që më pëlqen më shumë...	**Fjalët kyçe**: Kërkim në internet, gjetje, profesione.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - tregon hapat e kërkimit të informacioneve në internet; - dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet e profesioneve në libër me profesionet e gjetura prej tyre; - argumenton përmes sqarimeve përzgjedhjen e profesionit të së ardhmes. ***Kriteret e suksesit:*** Thuaj hapat e kërkimit të informacioneve në internet. Trego çka kanë të ndryshme/të përbashkët profesionet në libër nga ato që ke gjetur ti. Arsyeto përzgjedhjen e profesionit tënd.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, kompjuter/lap-top, adresa të ndryshme interneti, ilustrimet (mostra e profesioneve) në libër, lapsi ngjyrat.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për media	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1.

Ora mësimore fillon me aktivitetin "Po të isha… Do të kisha…". Secili nxënës shkruan dy deklarata në tiketat që ka përgatitur mësuesi/ja. P.sh. Po të isha mjek. (Tiketa tjetër) Do të kisha shëruar të gjithë njerëzit. Këto deklarata mblidhen në dy kapela të veçanta. *Kapela me "Do të kisha…" dhe kapela me "Po të isha…".* Secili nxënës zgjedh një tiketë nga secila kapelë dhe e lexon. Tiketat nuk përkojnë me njëra-tjetrën dhe në klasë krijohet një klimë pozitive, si dhe nxënësit në të njëjtën kohë hyjnë në temën e " Unë do të bëhem…"

Hapi 2.

Mësuesja/si kërkon nga nxënësit të thonë çfarë dhe si kanë hulumtuar në internet (detyrat e shtëpisë).

- Si keni hulumtuar në internet?
- A kishit vështirësi?
- Cilat profesione keni gjetur?

- Çfarë keni kuptuar për profesionet që keni gjetur?
- Si u ndiet kur hulumtuat dhe gjetët të dhënat që kërkonit? Pse?

Hapi 3.

Hapen librat dhe nxënësit vrojtojnë ilustrimet që janë në libër (të gjeturat nga interneti). Hapet diskutimi:

- Çfarë kanë gjetur fëmijët në internet?
- Sa janë të ngjashme me të gjeturat tuaja?
- Ku është ndryshimi?
- Çfarë kanë të përbashkët?

Diskutohet për rëndësinë që kanë këto profesione në jetën e përditshme. Analizohen veglat që përdorin secili prej tyre.

Hapi 4.

Në vazhdim, u kërkohet nxënësve të vizatojnë veten e tyre në figurën që tregon profesionin që pëlqejnë.

- Pse zgjodhët pikërisht këtë profesion?
- Çfarë të nxit ta mendosh veten në të ardhmen si mësues/gjykatës/futbollist…?

Nxënësit tregojnë në mënyrë individuale dhe argumentojnë arsyen e përzgjedhjes së profesionit të dëshiruar.

Hapi 5.

Secilit grup të nxënësve u caktohet një profesion. Ata duhet të inskenojnë një pjesë teatrale (lojë në role) për profesionin (mësuesja/si është kujdesur të sjell në klasë një element që paraqet një profesion si: kapele/mjet/vegël pune). Nxënësit luajnë lirisht lojë me role sipas profesionit që përfaqësojnë.

Vlerësimi i nxënësve
Puna praktike e kërkimet *në internet (mundësisht posedimi i kompjuterëve, nëse jo hapat që duhe*n marrë për të kërkuar informacione në internet). Argumentet në përzgjedhjen e profesionit të pëlqyer.
Detyrë shtëpie
Hulumto në internet për një nga hobet e tua, sport/muzikë/art etj.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Planifikimi			
Rezultati i të nxënit të temës: Planifikon kohën e mësimit, lojës dhe ndihmës në familje.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3; **II.** 7, 8; **III.** 1, 2, 3, 4, 7; **IV.** 1, 2, 5; **V.** 1, 4; **VI.** 3, 5, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.** 1, 2; **5.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
6.1 Njësia mësimore: Dita ime	**Fjalët kyçe**: Planifikim, orari ditor.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - tregon të gjitha veprimet veta ditore pa orare të caktuara; - përpilon orarin ditor duke u bazuar në veprimet që duhen bërë gjatë ditës; - arsyeton veprimet sipas orarit përmes të shprehurit me gojë. ***Kriteret e suksesit:*** Thuaj çfarë veprimesh bën gjatë ditës. Përpilo orarin tënd personal (ditor). Shpjego orarin para klasës.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, tiketat me ilustrime.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhe shqipe, shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësi për jetë, Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit.	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1.

Hapet diskutimi në klasë me pyetjen:

- Si e kaloni ditën, çfarë bëni? (nxënësit thonë të gjitha veprimet që kryejnë gjatë ditës, pa ndonjë orar të caktuar. Mësuesja/si nuk i gjykon.)
- A bëni një planifikim, si do ta kalonit ditën?

Hapi 2.

Mësuesja/si ofron tiketa me ilustrime të veprimeve ditore dhe u kërkon nxënësve të vendosin tiketat duke u bazuar në kohën kur kryejnë veprimin në fjalë. Nxënësit diskutojnë për veprimet që bëjnë gjatë ditës dhe përmes këtij aktiviteti arrijmë te rëndësia e orarit ditor.

Hapi 3.

Hapen librat, trajtohet tema *si e kalon ditën personazhi në libër* dhe analizohet orari i tij i paraqitur në mënyrë tabelore, veprimet dhe koha e kryerjes së veprimeve.

Hapi 4.

Nxënësve u kërkohet të përpilojnë orarin e veprimeve të tyre ditore.

- Thuaj aktivitetet që bënë gjatë ditës (higjiena personale, fjetja, sa orë kalon në shkollë, koha e pushimit, koha e mësimit, koha e lirë/loja/TV etj.). Secili nxënës vizaton në ilustrim akrepat e orës kur kryen veprimet ditore.



Hapi 5.

Përmes teknikës "Stilolapsi në mes" bëhet përzgjedhja e nxënësit që duhet të prezantoj orarin ditor që ka punuar. Nxënësit diskutojnë për rutinën e tyre ditore. Mësuesi/ja nxit nxënësit në respektimin e orarit ditor duke i vënë rëndësi të veçantë kohës së mësimit. Gjithashtu udhëzon nxënësit të vendosin orarin e tyre ditor në një vend të dukshëm që të shohin nëse e kanë respektuar atë.

Vlerësimi i nxënësve
Vendosja e veprimeve në kohën e duhur në përpilimin e orarit ditor.
Detyrë shtëpie
Vendos orarin ditor në një vend të dukshëm në shtëpi.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Planifikimi			
Rezultati i të nxënit të temës: Planifikon festa të ndryshme.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3; **II.** 7, 8; **III.** 1, 2, 3, 4, 7; **IV.** 1, 2, 5; **V.** 1, 4; **VI.** 3, 5, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.** 1, 2; **5.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
6.2 Njësia mësimore: Përgatitemi për festat	**Fjalët kyçe:** Planifikim, festë, organizim.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - thotë të gjitha festat që njeh; - vizaton një situatë feste sipas imagjinatës; - krijon një dekor feste në grup. ***Kriteret e suksesit:*** Trego cilat festa di. Vizato festën që ke imagjinuar kur ke dëgjuar muzikën. Puno një dekor për një festë të caktuar.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, letër me ngjyrë, gërshërë, vizore, ngjitëse.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare: Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukim për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë).	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1.

Orën e fillojmë me paraqitjen e fishekzjarrëve në sfond (projektor).

- Çfarë po shihni?
- Çfarë ju kujtojnë fishekzjarrët?
- Cilat festa ju kujtojnë?

Nxënësit thonë festat që festojnë. Mësuesja/si shkruan në tabelë secilën festë që ata përmendin, qoftë edhe ato të familjes. Në këtë mënyrë, nxënësit arrijnë të përmendin edhe festat që janë të pranishme në libër.

Hapi 2.

Nxënësve u kërkohet të vendosin kokat në bankë dhe të mbyllin sytë, të dëgjojnë tingujt e muzikës (mund të jetë kënga e festës së Vitit të Ri apo cilësdo festë) dhe me sy të mbyllur të imagjinojnë një situatë (festë) duke u bazuar në muzikën në sfond. Nxënësve u kërkohet të paraqesin atë që kanë imagjinuar.

Diskutim:

- Çfarë imagjinuat?
- Cila festë ju erdhi në mendje?
- Si e imagjinuat festën?
- Si do ta planifikonit ju një festë?

Hapi 3.

Hapen librat dhe nxënësit njihen me njësinë mësimore. Nxënësit orientohen te titulli i mësimit.

- Çfarë kuptoni me fjalën planifikim?

Lexohet teksti me ndalesa nga nxënësit.

- Cilat festa festojnë fëmijët në fotografi?
- Si i kremtojnë ata festat, çfarë bëjnë?

Hapi 4.

Nxënësit vrojtojnë në libër shembuj të ndryshëm të punimeve kushtuar festave. Udhëzohen që të përcaktohen për punimin që pëlqejnë ta bëjnë. Gjithashtu, mësuesi/ja mund të paraqet modele të ndryshme të punimeve në sfond (projektorë) për të nxitur ide dhe dëshirë për të krijuar punime për festat e ndryshme.

Nxënësit ekspozojnë punimet e tyre dhe tregojnë për cilën festë kanë punuar punimin, si e kanë planifikuar punën në grup, a kishte bashkëpunim të ndërsjellët brenda grupit?

(Në mënyrë të tërthortë dhe të thjeshtë informohen nxënësit për planifikimin e festave.)



Vlerësimi i nxënësve
Puna praktike (punimet e nxënësve) Vlerësimi i ndërsjellët
Detyrë shtëpie
Hulumto në internet modele për punimin figurave dekorative.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** I
Tema: Planifikimi			
Rezultati i të nxënit të temës: Arsyeton rëndësinë e planifikimit të ardhurave dhe shpenzimeve familjare.	**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.** 3; **II.** 7, 8; **III.** 1, 2, 3, 4, 7; **IV.** 1, 2, 5; **V.** 1, 4; **VI.** 3, 5, 6 **Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.** 1, 2; **5.** 1		

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
6.3 Njësia mësimore: Kur bashkëpunojmë, festojmë edhe më bukur	**Fjalët kyçe**: Planifikim, bashkëpunim, kursim, shpenzime.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore ***Nxënësi/ja:*** - shkruan një mendim si do të kontribuosh në planifikimin e festës; - planifikon punët dhe detyrat për realizimin e përgjegjësive që ka marr; - tregon rëndësinë e kursimit të shpenzimeve gjatë festave. ***Kriteret e suksesit:*** Trego si do të kontribuosh gjatë planifikimit të festave. Bëj me kujdes detyrën që ke marrë përgjegjësi. Thuaj rëndësinë e kursimit të të ardhurave në familje.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, letër A4 me ngjyra, laps, lapsa me ngjyrë, gërshërë, ngjitës, fije spangoje.	**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare: Globalizimi dhe ndërvarësia	

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1.

Hapet diskutimi në klasë përmes pyetjes:

- Si do ta kishit planifikuar ju një festë në klasë?

Mësuesi/ja ofron organizuesin grafik (Fletë A4, një rreth i vizatuar në mes). Secili nxënës i grupit duhet të shkruaj një fjali me ngjyrën që ka zgjedhur, për veprimin që mund ta bëjë për të organizuar festën. Në hapësirën e mesit, nxënësit në bashkëpunim (në grup) bëjnë një vizatim të shpejtë të një feste. Paraqiten punimet e nxënësve dhe diskutohen idetë e tyre.

Hapi 2.

Hapen librat dhe lexohet teksti nga nxënësit. Nxënësi/ja që ka lexuar paragrafin duhet të sqaroj me pak fjalë atë që ka kuptuar, të shtroj pyetje rreth asaj që u ka lexuar shokëve/shoqeve dhe të kërkoj nga shokët/shoqet të shtrojnë pyetje nëse kanë diçka të paqartë rreth bashkëpunimit për organizimin e punës për festën.

Hapi 3.

Mësuesi/ja orienton bisedën te materialet që nevojiten për punimin e dekoreve festive dhe shtron pyetjet:

- Si mendoni, mund të planifikojmë festat duke u kujdesur vetë për dekoret?
- Cila është dobia e vetkrijimit të dekoreve?
- A mendoni që shpenzimet festive do të jenë më të vogla?
- A mund ta bëni një gjë të tillë në shtëpitë tuaja?

Hapi 4.

Pasi nxënësit ndajnë detyrat në grup, caktojnë drejtuesin e grupit, marrin materialet e nevojshme, përcaktojnë punët që do të bëjnë, caktojnë shokun/shoqen që do të prezantoj punimin dhe fillojnë punën. Mësuesja/si vëzhgon punën e nxënësve, për të parë se sa të përgjegjshëm janë ndaj detyrave që kanë marrë përsipër.

Hapi 5.

Ekspozohen punimet në Turin e galerisë.

Diskutohen:

- Si u realizua detyra?
- Si funksionoi grupi?
- Është më mirë t'i krijosh vetë apo të punosh në grup me shokët/shoqet?
- Pse?
- Si do të veproni ju në shtëpitë tuaja gjatë festave që të ulni shpenzimet festive?

Në këtë mënyrë, nxënësit vërejnë rëndësinë e bashkëpunimit në planifikimin e detyrave/punëve në shkollë/klasë, dhe do të nxiten të mendojnë të planifikojnë për të kursyer shpenzimet.

Vlerësimi i nxënësve
Buletini i pjesëmarrjes gjatë punës (angazhimi, bashkëpunimi me grupin).
Detyrë shtëpie
Puno një figurë dekoruese dhe sill në klasë.

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna</td><td>Lënda: Shkathtësi për jetë</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: I</td></tr>
<tr><td colspan="4">Tema: Planifikimi</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultati i të nxënit të temës: Planifikon blerjet për festë familjare apo ato shkollore</td><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; II. 7, 8; III. 1, 2, 3, 4, 7; IV. 1, 2, 5; V. 1, 4; VI. 3, 5, 6</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 2; 5. 1</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="2">6.4-5 Njësia mësimore: Veprimtari: Përgatitim postera dhe zbukurime për festat</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: Festë, poster, material, vizatim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:
- arsyeton temën që ka zgjedhur për të punuar me 2-3 fjali;
- shpjegon rëndësinë e kursimit me 2-3 fjali;
- bashkëpunon me grupin për punimin e temës që ka përzgjedhur;
- paraqet bashkë me grupin pjesën e punës që ka bërë.

Kriteret e suksesit:
Përzgjidh temë që të pëlqen për ta punuar në grup.
Trego rëndësinë e kursimit në jetën e përditshme.
Sqaro kontributin tënd gjatë punës në grup.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, burime nga interneti (https://www.pinterest.com/pin/AfiphR8_qLr4XLpvOBC4GoySR-hVukmli626n4E7APMBNI8-lXfW-tg/) letër me ngjyrë, gërshërë, vizore, ngjitëse.</td><td colspan="2">Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Edukatë muzikore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë).</td></tr>
</table>

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Hapi 1.

Nxënësit të inspiruar gjatë trajtimit të temës së “Planifikimit” gjatë orëve të kaluara, nxitën për punë praktike. Punimi e posterave për ditët e shënuara/festat apo për tema që nxisin interesim te nxënësit.

Hapi 2.

Hapen librat dhe diskutohen shembujt në libër, gjithashtu nxiten nxënësit me ide të reja të punimit të posterëve apo objekteve përmes *link*-eve të ndryshme në internet (projektor).

Hapi 3.

Mësuesi/ja paraqet ilustrimin dhe shtron pyetjen:

- Çfarë mund të thoni për ilustrimin që shihni?

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë. Përmes diskutimit, mësuesja/si nxit nxënësit të kuptojnë rëndësinë e kursimit dhe të kursejnë gjatë përditshmërisë.

Hapi 4.

Nxënësit vendosin për posterin e pëlqyer (temën) duke u bazuar në libër apo në shembujt e sjellë nga *link*-et në internet dhe fillojnë punën.

Punimet e tilla planifikohen të punohen brenda dy orëve mësimore, pasi nxënësit duhet të sigurojnë informacione (internet, gazeta, revista) për temën që kanë zgjedhur.

Orën tjetër, nxënësit paraqesin punimet në grup.

Diskuto me shokun/shoqen paraqitjen e punës tënde.

- Ju pëlqejnë punimet e njëri-tjetrit?
- Çfarë materiali keni përdorur?
- Keni bërë shpenzime për punimin e këtij posteri?
- Si i keni planifikuar shpenzimet?
- Ka qenë e nevojshme të shpenzoni kursimet tuaja personale? (Jo, meqë mësuesi/ja në bashkëpunim me prindërit është kujdesur për një gjë të tillë.)

Bëni një konkurs në klasë.

- Punimi i cilit grup ju pëlqen më tepër? Pse?
- Si keni bashkëpunuar me grupin gjatë kësaj jave?

Bëhet përzgjedhja e punimit më të mirë me vota të fshehura. Punimi që merr më shumë pëlqime vendoset në rendin e parë të punimeve.

Vlerësimi i nxënësve
Planifikimet/bashkëpunimi në grup. Paraqitja e kontributit personal gjatë punës grupore.
Detyrë shtëpie
Bëj një plan të kursimeve të tua personale.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:37(075.2)

(Lipoveci) Pruthi, Laura
Libër për mësuesin : shkathtësi për jetë 1 / Laura Pruthi (Lipoveci). - Prishtinë : Botime Pegi, 2019. - 86 f. : ilustr. ; 20.7 x 28 cm.

1.Kuka, Ilir

ISBN 978-9951-786-13-3
Lejohet për botim me vendimin e Ministrisë
së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë,
nr. 416/01-B, të datës 23.08.2019.